BKST

BKSH

BKSH

BKSH

ASDRÉN

RÉZÉ DJÉLLI

VJÉRSHA LIRIKÉ

S'ka pùne m'é shejntnûmuŋ
per atèhén' kur lufton,
Si dhé per t'lulezûmun
ghuhen c'é kuvendoŋ.

BUKURÉSHT

SHTYPESHKRIM' I „PERGHITHESHME“ STR. COVACI, 14

1904.

BKSH

BKSH

1404 — 1904

PER KUJTIM TE SE PÉSE-CINTTES VJÉTESIE TE LINDJÉS É TE MADHIT BURRE É MBRÉT TE SHCIPERISE GHÉRGH KASTRIOTIT SKENDÉRBÉUT

„MACEDONIÆ ET EPIROTARUM REX"

CI MÉ TRIMERIN' É VÉT LUFTOJ SI LUÂN ACE LUFTA TE CHKELCYÉRA PER LIRIN' É ATDHÉUT, DUK' É MPROJTUR BURRERISHT CE TE MOS BJÉRE NE DORE T' ARMIKUT, DHÉ GHÉR MBE ORE TE VDÉKJÉS' SE TIJA DUK' É NDÉRUAR VENDIN É VÉT SI SHCIPETAR I VERTÉTE; É FAL KETE LIBRE MÉ GHITHE ZEMER.

BÉRESI.

BKSH

BKSH

PARETHENIÉ

Ce te shkruash ghuhen Shcipé s' eshte pun' é rende ; po, s' esht' as ac' é léhte. S' esht' é rende sé Shcipetari é ka dashur kurdohére ghuhen é tij ce é mekoj nga siset é s' emes ; prove eshte sé é ka dashure édh' é dô, kémi kete pascyre te forte: Shékulla permi shékulla shkuan ; ñe grusht ñéres, pa t' a shkruajne pa t'a perdorin si te tjére ghuhen é tyré, é mbajtne véch duk' é folur, ghitheñe mé ñe kryélartesi te ralle! Sa kombé s' u-perzjéne ce me kohera édhé s' u-shuan kréjit, kur barbaret si mizerija hidhéshin mi 'tô dhé shkrétonin pa meshire ch' do ce u-binté mb' udhe ? Po Shcipetaret, mé ghithe ac' é ace trazimé é vojtjé munt te thémi é mbajtne ghuhen é vét, si ñe kujtim é ndjéñe atdhésié ce po te ish tjater komb ac sa eshte Shcipetari ce shume do te ishté fshire nga fac' é dhéut. Sa kundershtimé, sa perpjékjé, sa propaganda nuk behéshin édhé nuk behén é sot m' ane te shkollavét, m' ane te kishes nga ghithe fciñet t' ane? Po te ghitha kane vajtur me kot, sé eshte pune ce u-deftyé sé nuk mundét ce te chreñosét ace léhte ghuha Shcipé ; é, mé ghithe ndryshimét é fése, ce jane ndare Shcipetaret, shohim sé as keto nuk' vé-peruan mi 'ta ce te harrojne ghuhen é tyré pervéch tsa ce déshnin te hyjne ne sherbim te te huajvé, ishin shtrenguar

te mesojne tjater ghuhe, a duké trégetuar édhé duké u-larguar nga vendi i tyré, é harruan ghuhen é vét duké u-perzjére mé te tjére. Ashtu ce ch' do Shcipetar, thém, munt t'a mesoñe é t'a shkruañe shpéjt ghuhen é vét, si ch' é mesojne édhè te tjére te tyrén.

S' esht as az' é léhte, thashe, sé sot per sot névojat édhé kerkimét é kohes u-ndryshuan shume, édhé ashtu si ghéndét me s' mundét te véje shume, po duhét ñe mundim é ñe perpjékjé si édhé durim ce te dale édhè Shcipja nde ñe fytyre si ch' jane ghuhet é tjéra. S'esht é léhte thém sé shkroñetori shume hére ghéndét nde ñe ndalim a péngim mé mos ditur si te ghéñe mire é mê mire ch' do fjale ce ka névoje per te deftyér, é me téper per vjérshat ku ghuha duhét te riédhe ne mos si ar é kulluar, faré te paken si erghent t' i nghase atij mburimit ce mburon i kulluar po hére hére ghithe ndzjér nga thélbi i dhéut nga noñe hâle. Perandaj ch' do Shcipetar ce do ghuhen édhè kombin é vét, duhét te perpicét mé sa fuci ce ka, t' i sjélle Shciperise se varfere dhé fatkécé nga ñe kanisk zemré, duk' i vene krahun t' i ndihje ce te dale édh' ajo nga balta ku ka rene, ch' do Shcipetar thém, mé sa munt duhét t' é chperlaje ce t' i sherohén plagat shékulloré te tsilat êdhé po é mundojne é s' é léne te mare fryme!

Ay ce mendon ndryshé duké thene sé ghuha Shcipé eshte Masonerie, *atij s' munt t' i thém pervéch keto:*

Mason esht' ay ce tradheton memen é tij duké perkrahur te tjéret per humbjén é saj! Pra, therés mé ghithe zémer: Ndér atyré burravé ci mé ndjéñat é tyré te chélura per atdhén' édhé per ghuhen u-perpocne é na lane miaft sheña sé Shciperia ron; ndér, thém, per ata ci sot jane vene é behén thérror per nghalljén é Shciperise, duké ndihur sitsilido kush mé mendjé kush mé pasjé, é dore per doré duk' u-perpjékur nat' é dite te ndézin zjarin te pa shuar ci, ñe dite ka per te shendritur ne bote. Ndér édhé te ghithevé a-

tyré ce prapsin mé kudzim ch' do premptimé ce u bejne armicte per te shuar kete shkendije, é s' geñéhén mé lajka, po mé ñe chilterie te pa refyére dalin mé balle perpara armikut, édhé s' é mohojne kombesin' é vét po mé kryélartesi i thone: „Jam Shcipetar!" Lavdim ketyré! Mundét ce te mohosh ghuhen t' endé? Ahéré moho édhé Pérendine! Munt ce te ndalosh te t' eme ce te mos é flase ghuhen é saj? Oh, kurre kio mos cofte thene, atehéré mohon vétehén t' endé, cuhésh ñe i poshter tradhetor!! Édhé ne cofte sé ushcén ñe ndjéñe te ketille, édhè kerkon te hélmosh mé kete hélm édhé vellézerit é tû, ahéré? Oh, ahéré largo-u, tutjé, sé me s' duhét te rish prane saj. Atehéré édh' ajo duké te mallekuar do t' te thote: Tradhetor, étse atjé ku te cellon zémra, atjé per ku i ké ndjéñat, t' u sherbésh atyré ce ti i dô, édhé lér-é Shciperine sé esht vét' é zoña te perkujdését per ate ce i mungon. Masonerî sé s' te jép te lepish kotska, kur ti si tradhetor bashke mé ata ce thua sé i ké vellézer i a thethijte ghakun.

Marim ketu per shembell t' u-thomi atyré ce perpicén mé ch' do menyre ce t' a ndalojne ghuhen Shcipé, vétem keto fjale te te ndyérit Efthim Mitkos:

„Ce te duan tsa t'a permbytin ghuhen Shcipé duké perdorur „mé pahir ghuhen Grécishté mé cellim ce te chreñosét é te „shuhét faré, é t' a sjéllin punen keshtu ce te thone sé „s'eshte komb Shcipetar, geñéhén liksht; kio eshte ñe chpikjé „é ñe mendjés se prishure, politik'é kalbure, é ñe perkun-„dershtim ch' do idhéés se madhé".

Keto thote i pa-vdékuri Efthim Mitkua, duké keshilluar Grékrit si te sillén mé né, nde parethenié te librit te tij „Bléta Shcipetaré".

Po Grékrit me tjater ane mé ñe kudzim é mé ñe paturpesie te pa deftyére mé sé t'i u mundét bejne si é si t'i ngaterojne punerat duk' u-perpjékur mé ch' do menyre dhélperishté per humbjén é ghuhes s'ane, duké léhur mfshéhtazi

é duké share ata ñéres ce s' bejne ghekafshe pervéch sé i sherbéjne atdhéut, asaj Shciperie c' u-dha jéte édhé drite, sikundr' édh' ata Grékrit véte bejne per atdhén' é tyré, duké thene sé si mundét ce tsa Shcipetare te prishure perpicén me kot, kur tere Shcipetaret é méntshem, é kupetuan mire-fillit sé vétem mé Gréket é ghuhen Grécishté mundim te dalim nde cytéterie, sé Shcipéja esht é humbure, édh' ata ce nuk mendojne keshtu jane tru-semure!

Po shohim sé Gréket jane ata tru-semuret, é jo né, sé ata duan te grabitin ate me te sheñteruaren ghe ce kémi, ghuhen! duké perdorur ch'do végl' é almitsa ce te mos ludézohét kurre! kete ghuhe ce é kémi talisman nga sterghyshrite t'ane! é kur né duk' u-perpjékur per kete cellim te pa chmimuare, Gréket vijne te na thone, nde ñe gazéte ce perpicét te beje lidhjé midis tyré é nésh, sé jane tsa Shcipetare te tsilet i kane trute te semure, te tsilet jane te chmendur!

Te chmendur sé perpicén per kombesin' é vét, te chmendur sé mprojne te dréctat é tyré, te chmendur sé nuk lihén te chkombesohén préj ch' do te pare-ardhuri nde vent te tyré; sé kupetuan mire ce kane te bejne mé dhélpra. Keto i dine tere Shcipetaret atdhétare. Po édh' ata ce s' i kane kupetuar akoma, shkaku eshte sé kane hyre nde gratskat ce u-jane ndéhur, shpirtin é kane te hélmuare, po s' kane ch'te bejne dhé sa po vété ghithe shuhén, sé Shcipetari u-zghua édhé Shcipéja ka shtjére miaft reñe, é rézik s' eshte sé do te chreñosét, sé sa po vété ndjéñat kombetaré po shtohén dita mé diten per tsmirin te tjerevé.

Shkurt, duam te miren t'one, édhé jo te ligen é tjaterit.

Valle né kerkojme te grabitim te dréctat é tyré, duam t'u sjéllim dem Grékevét sé nuk' é duam ghuhen é tyré? jo! é duam ghuhen Grécishté, si ch' é duan édhé shume te tjére, munt tsa me téper sé sa é duan édh' ata Grékrit véte, po me pare se ghithash duam ghuhen t'one! Pra, per

kete shkak, per kete pune bertasin sé jémi te marre, sé perpicémi me kot, duké na mihur varrin! Po koha do t' a refëñe, sé bota ashtu eshte: kush i ben varrin tjaterit, bié ay véte 'brenda.

Po, t' i léme Gréket nde enderat é tyré, si ch' thote édh' i ndriteshmi atdhétar Faik béj Konitza: C'est un crime de troubler le bonheur des innocents. Laissons les bons Grecs à leur bonheur.

Ky liber u-shtyp mé shkroñat Latiné. É zghodha kete alfabét per kete shkak: sé shkroñat Latiné ghéndén kudo, é munt ce te shtypesh ch'do libre, — munt ce édhè keto te mos jéne pas névojes se ghuhes, po kane kete lehtesie sé i ghén nde ch' do vent—pastaj kete abétar é perdor tere bota é cytéteruare, é, pa dyshim sé ghuha Shcipé ka névoje te madhé per kete, facé mé te huajt. Mé te vertét do te thone tsa sé keto shkroña nuk' jane perhapur neper tere Shciperit, édhè Shcipetaret shkroñat biñaké s' mundin t' i chkocitin. Ketyrevé Shcipetare u-perghighém vétem keto:

Si mundét kur ñe Shcipetar ce meson Turcishtén, Grécishtén, Italianishtén é shume ghuhera te tjéra mê te renda te mos mundje te mesoje disa létra te ndryshuara pa te jéne te renda po vétem sé jane biñaké? Kio eshte faré djalerie. Sot kur kémi névoje per te shtypur ditaré é libra kudo ce te ndodhét ñériu, duhét te léme me ñ'ane ch'do interést, po duké u-bashkuare, te bejme ñe ghe te perbashkune, te forte, te ghalle ce t'i jape ndér Shciperise édhé Shcipetarevét. Perandaj kam shprése sé atdhétaret ce ghykojne thélle do te jéne mé kete mendim.

Keto vjérsha ce facésoñ kendoñesvét munt te mos jéne ace te forta, ce te jéne ñe kryépune; nde keto pascyrohét me téper dashuria é atdhéut, dashuria é atij vendi ce te ghi-

thevé zémra na can mé lot kur é kujtojme, po kréjit é kémi lene nde ñe harrim ce vétem ndér nuk'na sjéll si Shcipetare.

Keto vjérsha ce te ghitha jane te thjéshta bere préj zémres mé sa me ndihu fucia é mendjés édhé ghuha. Munt ce disa Shcipetare t'i ghéine te liga, sé si ch' provova tsmiri édhé nakari nuk' u-mungon shume Shcipetarevé, po une u-thém keto: ace munda ace bera lé te bejne ata mê mire, une gezoném vétem kur dalin nde drite shume libra ce te ñihémi sé rojme édhé né, sé ch' do libra ce dalin, per Shciperine jane rézé djélli.

Me tjater ane ñe lutjé u-beñ kendoñesvét: ce ch' do gabimé ghuhé a shtypi ne cofte sé ghéjne te m'a falin fajin, sé sado te ruhét ñériu, andéj ketéj ghithe shkasin nga noñe hére, pastaj sa per ghuhen me ch' ghendjé eshte, é dine fort mire.

Tétor 1903 **Asdrén**

BKSH

ATDHÉSIÉ

BKSH

BKSH

Unguibus et rostris.

O zâna te pérendishmé
Ce kendoni trimerite
Dhé lumtesin' é ñérezis',
Shciperise se tanishmé
Jipni-i édh' asaj drite
Te shohe rézét é liris'.

Viose, Drin dhé ti o Shkumb
Ci valoni mé ac buchim
Dhé te lire kini cene,
Per sé keshtu sot por si plumb
Ju nuke ngrihi per lirim
Po nde ghume kini rene ?

Tundu Tomor ! ngréhi kryét
Édhé hap-i krahet' é tû
Ne jé ghithe ay ci cé,
Ndene ty bej ce te thyét
Roberia ci, ce ketu
E ace cint vjét ti é ké !

BIBLIOTEKA

Lart ! lart permi shkembiñte
Atjé ték shcipoñat rine
Dhé barbaret s'kane shkélur,
Tomor ! atjé mblith te riñte
Te perpicén per lirine
Ce te viñe kembe chélur !

Valle nuke jane ata
Ci cemoti po luftonin
Per lirine ac trimerisht ?
Te mos jéne édhé disa
Si ata ce i largonin
Armicte ac hér' burrerisht ?

Éjani o Shcipetare
Si luâna te luftoni
Per kete mendim te sheñte,
Dhé te deftéhi te pare
Tere botes jû t' i thoni
Sé atdhéu esht i shtreñte !

Hékurat ce sot é mbajne
Te lidhur duar é kembe
Dhé fryme s'é lén' te mare,
Ato mos i lini t' a chajne
Po thrimoni-i mé dhembe
Ce te mos é hécin dzvare !

Perghoni ! mé vrap trumbétat
Mé buchim si u-therésin
Per luftim te jini gati,
Édhé pushkat te pa métat
Te ngarkuara ju présin
Ce sot t'i chkrépni perseri !

PISH

Se largu ñe ze tingellon
Zer' i bukur i lirise
Ce malét jane nde ghemim,
Dhé Shcipetari sot po shkon
Ték trumbét' é ushterise
Po é therrét per luftim!

Ngrihi djém te ghith mé shprése
Atdhéne ce te shpetoni
Dhé mos vononi as pike,
Ay eshte fé dhé bése
Per 'tê mé kudzim luftoni
Burrerisht édhé pa frike!

Oh! ch' pertoni keshtu valle
Perpara o ushtetare
Te ghithe suli pa vonim,
Mproni-é mé kordh' é palle
Atdhén' êdhé te pandare
Sé s'eshte kohe per meñtim!

Ch'zemer te ftohete kini
U-be dite, drita chkrépi
Shciperia kerkon shpetim,
Ushtetare mos é lini
Sé ay vent eshte djépi
Ce u-riti mé mallenghim!

Atjé! atjé éshtrat ndodhén
T'uajat é t' Skendérbéut
Dhé prindrit kini varrosur,
Ah! ato beni te chlodhén
Mos shkélén mi fac' te dhéut
Nga armict' é nemosur!

Armic! jashte jasht' atdhéut
Né linani nde cétesi
É mos na futni jû nde zjart,
Sépsé bijt' é Skendérbéut
Ce t' u-chperbléjne ch' do ligesi
Me s' u-shpetoni as nde varrt!

O, mos dhente i madhi Zot
Te mos duam dhéé, po véch ghak
Ce te ngopémi né mé 'tê,
Ahér' me s' do t' na mbani dot
Sé sado ce na dini pak
Do t' u-shuajme ghér me ñe!

Kurre, kurre s' munt te jéte
Shcipetari ac' i vdékur
Ce te roje nde roberi,
Sé ka zémer te vertéte
Édhé krahuné préj hékur
Ce s' é mposhton dot as ñéri!

BIBLIOTEKA

FLAMURI KOMBETAR

Nghyr' é kucé si é zjarit
Dhé shcipoña mé dy krére,
I-céndisur mé fill t' arit
Gher' é ghate bukur prére.

Cindra vjété kane shkuar
Dit' te zéza é plot mé zî,
Po ty fama s' t' eshte shuar
M' ghith c' u-tréte u--beré hî.

Ate dite ti c' u-shojté
Shcipoña pra na fluturoj,
Po sot jéten ti c' é ñojté
Ajo prape me ty cendroj.

Ushtetare te shendoshe
Mé ñe zemer é te flakte,
Moj shcipoñe bukuroshé
Po mundohén jo te pakte.

BKSH

Ti jé yll' i miresise
Édhé enghell' i shpetimit,
Sé ti i dhé Djélmurise
Lulén bukur te Kujtimit

Ndene ty pra Djélmuria
Mé deshire é mé shprése
Do t' luftoñe ce Shcipria
Te roje é te mos vdése!

BKSH

ARDHI DITA

Ardhi koha, ardhi dita
Iku nata dolli drita;

Ngrihi trima mos pertoni
Kete kohe t' a shpetoni.

S' eshte mjaft sa duruat ,
Édhé ter' ato ce vuat ?

Eshte turp per émrin t' uaj
Te mundohi per te huaj !

Citni pallen si ju dini
Édhé kordhen ne é kini,

Mé ghith zémer' é pa ndjése
Bini cénit te pa-bése !

Mjaft mé roben te chjére
Mproni vatren, mproni ndére !

BKSH

Ch' mbani duart si te thata ?
Ndzirni shata édhé shpata,

Férrat, ghembat i ceroni
Lulé te mbijne ne doni.

Per trima jû trima jini
Kete dhé ju vét' é dini

Po ch' dobi esht per atdhéne
Kur s' esht ashtu si ka cene !

Shciperine ju ne doni
Nga ket rézik t'a shpetoni

Kryét ngrihni, zghédhén shtini
Pastaj lumtur ce te jini.

Ne jini ju atdhétare
Dhé te thjéshte Shcipetare,

Beni-é ju sot atdhéne
Si ch' cé nene Skenderbéne !

BKSH

BOTA

I

Véra u-afrua
Dhé dimeri po shkon,
Bilbili u-zghua
Nga ghumi c' é pushton.
Malé, brighé chélén
Dhé sot si kurdohér',
É cénghi mé délén
Po lozin nde prehér.

II

Vjéshta tashi hyri
Dhé véra flytyroj,
Kudo c' kthéhét syri
S' shéh véch ñe jét' ce ndroj.
Ditet, vjétét shkojne
Dhé bota po kembén,
Ghith sa jane ndrojne:
Véch Shcipria me s' kthén!

BISH

KESHILLE

burrani Shcipetare
Sot per sot mblidhi nde bashkim,
Sé véch keshtu te pandare
Mundni t' jini nde perparim.

Dituri, liri s' fitohén
Pervéch kur eshte dashuri,
Sé ndryshé ato largohén
Édhé rojme si bageti.

Mos u-hani, mos u-ndani
Sé armicte ate présin,
Po vellézerin' é mbani
Nga nakari ce te vdésin.

Mos deghoni ata ch' thone ;
Sé jémi ghith ñe fis mé 'ta,
Keshtu é kane zakone
Ce t' jéne siper ghith ata !

BUSH

Ata nuke duan kurre
Te na shohin nde perparim,
Po te jémi ghithe drure
Ce te na gdhendin pa pushim.

Shcipetari s' munt te jéte
Thone, i cytéteruar;
Kjo esht faré é vertéte
Sé s' ka ghuhe per te shkruar!

Pra, si mundét vellézeri
Né te bejme mé armikun,
Kur ay mé paturpesi
Vét' na é refén rézikun?

Shcipetari mé ghith zémer
S' do pervéch sé Shciperine
Sé ajo i dha atij émer
I-fali dhé trimerine.

Pra behuni Shcipetare
Mé kete flamur ne dore,
Ce te véje puna mbare
Te mos cuhi tradhetore!

BKSH

PALLA é SKENDÉRBÉUT.

Trimeria é Skendérbéut
Ci cé deghuar n' anet é dhéut
Kish frikesuar Turcit tere
Ce s' dinin sé ch' cé per te bere.
Per kete pune Sulltani mentoj
É tsa ñéres te zghédhur dergoj
Te tsilet, pas urdherat c' u kish dhene
Te véne te shohin Skendérbéne.
T' i shohin édhé pallen te levduar
Mé tsilen kace lufta kish leftuar.
Valle ch' fare do t' jéte kio palle
Ce s' i la as ñe ushtetar te ghalle?
Keta nde Shciperi po sa vane
Édhé Skendérbéjne si ch' é pane
— Nga mbréti, thane, jémi derguar
Ce te shohim pallen ace te levduar.
Rréth é rrotull mesalles ku rinin
Neper tere anet syte po i shtinin,
Pane roba, pane arme te arta,
Pane kordha édhé palla te zjarta,

Po pallen te deghuar nuk' é ñihnin
Édhé me vent nuk' u-vinté te rinin.
Po trimi ngrihét é pallen mér ne dore:
„Dilni jashte pake, thote, o te ghore!"
Jashte po sa dualle mé chudi pane
Ñe kale ci cé lidhur atjé prane.
Skendérbéu afrohét, é mé pallen ce mban
I-bié kalit, é ce nene bark é siper me dysh é ndan!
Keta keshtu si pane u-hocne ghér ne mur
É atjé mbétne me vent po si ñe gur.
Pastaj i casén Skendérbéut prane
Ce t' a pyésin per ter' ato ce pane.
— Ch' fare cenka, thane, kio palla joté
Mé ac' trimeri ce na refén zoteroté,
Kur mbréti yn ka t' arte t' erghentte
Te mvéshur ghith mé gure te shtreñte
Palla tij ci ne lufta ce ghemon
Édhé cytété te mbedha ce dermon
É kio ac' é rende é ac' é ghate
Munt te luftoñe mé 'tê dit' é nate?
Po trimi perghighét é u-thote urte:
„Vin' i thoni mbrétit t' uaj zémregurte
Sé s' prét palla c' eshte ñe hékur i dhéut
Po prét dor' é fucishm' é Skendér-béut!"

BÉSE DHÉ SHPRÉSE

Enghelli i Zotit krahe hapur
Prape mé vrap préj ciéllit zbrét
Sé vasha, ce la, mé duart zghatur
Ka mjaft kohe ce kur po é prét.

Nat' é zéze, éresire kudo ;
Vasha mé frike é pa dhene zê
Di, sé dhé kete hére domosdo
Ay s' é ka per te harruar mê.

Enghelli pra sosi buze céshur
Po vashen é ghéti te hélmuar,
É mé roben é ziés te mvéshur
Syte mé lot é zene te shuar!

É mjéra vashe prane kur é pâ
I u-chél zémra édhé mé ñe gas,
Hodhi duart, é pa deghuar ch' tha
É zuri per krah ce t' i véje pas.

BKSH

Ku dô keshtu ce te véch, moj vashe
É ketu psé nuke do mê te rish,
Si ahér' kur ika é te lashe
Po tashi mé mua kerkon te vish ?

Shoh édhé une sé jé kembyér
S' é ké mê facén si ate hére,
Tashi ti cenké me dysh é thyér
É per tyne s' paska érdhur vére !

Rî ! sé ketu te roje esht dhene
Ch' do ghe ci préj Zotit esht békuar,
E kur te kthéhém : kam per te thene
Sé te ghéche shume te hélmuar !

O enghell dua mé ty te vété
Dhé perpara Zotit te cañ mé lot,
T' i thém une véte si me ghété
Sé ty mos te véje lutia kot.

T' i thém per tere keto ce vuañ
Zémren t' i a hap te m' a veshtroñe,
T' i thém sé nuke munt mê t' a ruañ
Sé sitsili dô, t' m' a tsopetoñe !

Âter, vellézer me kane lene
Rrotull méjé te ghitha renkojne,
Malét nuk' jane si kane cene
Ah ! as bilbilet me s' kendojne !

Mos u-hélmo, moj chupeze, ace
Po ri me vent, é me Zot ki bése,
Sé kush é béson Ay sa kace
I-ép fuci é te madhé shprése.

BKSH

Mos u-tremp nga kio éresire!
Sé Ay me dergoj ce ku céshe,
Te te thom sé néser duké gdhire
Ti do te behésh Mbréteréshe!

BKSH

DYSHIM.

Kohe, ci mé vrap shkon
Dhé botes i sjéll ndrim,
Ti ñérine c' é zghon
Mos me lér' nde dyshim.

Kur do te shoh valle
Yllin te shendritñe,
Shciprise mi balle
Mé chkelcim t' i ndritñe ?

Kur do t' vij' aj' ore
Shcipoña te zghohét,
É mé arm' ne dore
Armikut t' i leshohét ?

Zoghte t' i véne pas
Mé kryét perpjéte,
Sé s' duhét ce te flas
Kur ata din' véte ?

BKSH

Ace lark esht dita
Dita thém é sheñte,
Ce te chkrépñe drita
É liris' se shtreñte?

O lémjé tund-u
Dhé ti o pérendim,
Bote sa jé shkund-u
Perpic-u mé bumbullim.

Shciperi é mjére
Prit, prit nga bijt' é tû!
Ky ghum' c' i ka blére
Nde vdékjé i ka chû!

Éresire ri me vent
Faré mos u-levis,
Sé ti ñérin' é dent
Mé vojtjé mi kurris!

Shcipetari mé ty
Esht mesuar sado,
Kur vété s' shéh mé sy
Si é geñén kushdo.

Dhé ti djélle cendro
Mi 'tê kurre mos ndrit,
Po me tjatr' an' i cho
Rézét ti ce i cit!

Sé Shciptari nuk' do
Drite, sé i zbulon
Mekatne c' domosdo
Syte i a vérbon!

BKSH

Véch ti *hene si drap*
Ti kurre mos u-mfshéh,
Sé ty te falét mé vrap
Édhé naten kur flé ! !

BKSH

DUA

Mi bar dua te préhém
Te kendoñ te defréhém!
Te shoh rréth bagetine
Kur hane édhé pine.
Te shoh fushat é bléera
Bimrat kur i fryn éra,
Ñérezit kur punojne
Dhé chupat kur kendojne!

Ah! dua édhé lulét
Kur i chfacin pékulét!
Dhé flytyrat ce véne
Mi 'to dua te jéne,
Bilbili t' i a thote
Djélli t' jét' i ngrohte,
Pylli te ghélberoñe
Cycja te mos pushoñe.

BUSH

Dua dhé Shciperine
Sé atjé kam shtepine,
Ku riña neper férrat
Édhé losña mé shcérrat,
Per keto kam deshire
Édh' as dua me mire
Véch atjé dua te shkoñ
Sa te jém é sa te roñ!

BKSH

POSHTE ÉRESIRA!

O Shcipetare psé rìni si te ngrire
É ch' prisni jû valle ashtu si te mpire?
Levisni kembe, levisni édhé duar
É mos kerkoni te ghéni ghe te shtruar!

Ju pshatra édhé cytété valle ch' prisni
Psé nga éresira ku jini s' levisni?
Drite, liri, cytéteri jû kerkoni
Duart ato u-zghatin, psé s' i veshtroni?

Ch' eshte ky ghum' i rende ce j' u ka zene
Ce s' j' u lé te hapni syte, ch' do me thene?
Shciprise varrin psé vét' i a rremoni
Po nga balta ku ka rene s' é shpetoni?

Valle nuk' shihni rrotull kombét é tjére
Ci kane cene ghithe si jû te mjére,
Lirin' é tyré ce te mos é humbasin
Armicte mu ne funt de dhéut i kllasin?

BKSH

Valle ku é kini ate trimerine
Ce levdohi ace, per atê Pérendine,
Jû ci per te tjére faré s' é kurséni
Psé, atdhén' é lini t' vuañe si céni ?

S'kini turp Skendérbéjne kur é kujtoni
Dhé ghak' i tij ne rembat u-riéth te thoni ?
Si, ay sa rojti Shciperia ish nde drite
Edh' ay ce kur vdic u-be me kete dite ?

Si ! Shciperia êdhé do te renkoñe
Édhé shume kohe mé sy do te shekoñe,
Bijt' é saj mé thoñ é mé dhembe t'a chjérin
Édh' ate fryme c' i mbét faré t' i a ndzjérin ?

O juvé kordha édhé palla ku jini
Psé atyrevé ce j' u-mbajne s' u-bini ?
Juvé arme te fajkuara ch' u-bete
Psé s' i dergoni édhé jû n'ate jéte ?

Tundi o brighé, tundi édhé jû o malé !
Édhé jû réé psé tundi ashtu nga dalé ?
Ruféte chkarkoni, shkembeñte chkallmoni
Permblithni-i zuzaret édh' é ceroni !

Me ñ' ane féte, béset édhé tradhesia
Me ñ'ane ghaku édhé harbutesia !
Posht' éresira, posht' édhé roberia
Rofte bashkimi, rofte vellézeria !

Gége, Toske, ziruni dore mé dore
Édhé lirine shtini-é mi Tomore !
Ghakun psé valle jû é kurséni ace
Kur pa ghak mundni t' a fitoni sa kace ?

Ne é lenchi atdhéne ne kete dite
Mallekim do t' mbétét mi jû é mi bijte,
É nga fac' é dhéut faré ne u-shofte
Ahéré, dhéu u-hapt' é u-mbulofte!!

BKSH

DESHIRE

Fry moj ére
é mos puchê,
Kurr' ndoñ' hére
mos me harrê.
Fry moj ére
m' embelsire,
Si nde vére
m' ép deshire.
Fry moj ére
mé nga dalé,
Fry dhé ñ' hére
ng' ato malé!
Fry mos cendro
ére mos ri,
Embel m' kendo
si n' Shciperi.
Ér' mos vono
fry mé ndzitim,
Dhé me shpeto
nga ky trishtim.

BUSH

Ér' mos harro
Kudo ne vafsh,
Po me kujto
ashtu me cafsh!
Mos u-largo
po fry ketu,
Dhé me gezo
mé gast' é tû!
Ti prape fry
po mé shpéjtim,
Édhé me shty
nde dhéu t' im!

BKSH

ZERI I FLAMURIT

Perpara, perpara flamuri u-ngrit
Zini brighét, shtighét, malét perpjéte,
Atjé, atjé nghituni te ghith mé ndzit
É ndene valat é tij sitsili t' jéte,
Sé atdhéu mé mall nga bijt' é tij prét
Shpetim mé te vertét.

Te ghithevé sa ghaku ce u-levrin
Édhé ndzéhte nde zémer i u-valon,
Lini me ñ'ane féte dhé merin'
É ngrihi, mblidhi sé koha kalon
Ndene flamurin é sheñte mé shpéjtim
Per t' atdhéut lirim!

Ay! ay eshte flamuri yne
Ce sterghysherit t' ane é ndéruan,
Mé ate kudo ce van' édhé hyne
Armict' i shuan, Shciperin' é zghéruan.
Pra, ay eshte sheñ' é trimerise
Dh' enghell i lirise!

BKSH

Oh, véch ahér' ka vlére trimeria
Kur per atdhén' ajo dérdhét pa kursim,
Kur armicte shuhén si mizeria
É flamuri eshte nde ndér é lavdim!
Pra perpara djém, sé s' do Pérendia
T' vdése Shciperia!

Sa jéte ka djélli ci me ciéll chkelcén,
Ashtu dhé Shciperia mé bijt' é saj
Do te mprohét, dhé cellimin s' é kembén;
Kurre s' mposhtohét, kurre s' bié n' vaj
Sé shcipoña sa hér' hidhét mé zemrim
Kudo fiton lavdim!

BKSH

TINGELLIM

L. J. Ghin Aladro-Kastriotit

Por si drita ce chkrép duk' u-gdhire
Dhé bimen nga vés' é nates é chél,
I-jép jét' é fortse me te mire
Te ritét t' lulezohét po sa dél.

Ashtu édhé Jû Zot, ghuhen t' one
T' a beni sot ce te perparoñe,
Sé véch mé atê per ghithemone
Shciperia mundét ce te roñe.

Ashtu, atdhéu nde ate dite
Kur kete do t'a kéte fituar
Munt t' i kéte tere miresite;

Édh' ate ci per 'te ka punuar
Do t'a chcuañe nga ter' te bijte:
Mé dafina duk' é kuroresuar!

BKSH

MALLI I ATDHÉUT

O zochka te bukura lark ce fluturoni
Jû ci te vrapuara éren é trazoni,
Thoni-me valle asaj udhé ték shkuat
Nde malét é Shciperise nuke cendruat?
As thoni-me, u-lumte goja édhé penda
Sé te i u-deghoñ shume, shume me k'enda.
Trégoni-me mé ate ze c'eshte si mjalte
Sé nuke munt te duroñ; Zoti i u-falte!
Vall' i pate ata brighét ce ghélberojne
Édh' ata malét ci ac' é zbukurojne?
I-pate ato fushat, pyllét dhé lumeñte
Ato fshatrat si édhé ñérezit' é shtreñte?
Oh! hicni zochka te gezuara fluturoni
Nde majat é lartra te malévét cendroni,
Barisni kudo, mé syt' te ghitha i shihni
Ce kur te kthéhi te mi thoni si ju dini!
Me thoni ushetimn' é pyllit, ghemimn' é malit,
Kenget te malléshma te vashes é te djallit
Me thoni pérendimn' é henes, lindjén é djéllit,
Diten, naten édhé te céshurin é ciéllit!

Embel te lighironi, zemren te m'a chmallni
Deshiren te m'a mbushni, shpirtin te m'a nghallni,
T' me chélni si prendvéra, ci chél trendafilet
Édhé zê me jipni te kendoñ si bilbilet !

BKSH

MIAFT!

Shcipetar mos vonô po ngréhu
ji gati!
sé tashi
Per shpetim te therét atdhéu!

S' u-ngopé Shcipetar ce ri
i chvéshur!
i nghéshur
Nde vojtjé édhé shtyrani?

S' te tundét zémra joté faré
kur shekon
é deghon
Per humbjén t' endé kombetaré?

Shekon sé armicte nuk' rine...
po flasin
te kllasin
Ndene zghédhé sot Shciperine!

BKSH

Ti ku jé, ku 'shte trimeria
ce thua
sé s' dua
Ce te humbase Shciperia ?

Kerkon te refésh mé te kotta
sé jé trim
per levdim ?
Po véch mé fjale s'trembét bota....

Sot kombét ci ty te rréthojne
s' te ñohin
s' te shohin
Dhé kombesine t'a mohojne !

Gréku, thote, dua Janinen !
keshtu di
sé kufi
Une kam Vloren é Kaninen !

Mal-i-Zi édh' ay lot lodren....
dhé s' pushon
po kerkon
Pa prâ Malesin' é Shkodren !

Bullgarí dhé Serbi si ñe trup
mundohén
t' afrohén
Ñeri nde Manastir tjatri nde Shkup !

Ty ch' te mbétét valle Shcipetar !
a po s' ké
permi dhé
Véch sé ñe tsope vent sa per varr?

O ciéll chil-u nde hapesire
dhé shtjére
te bjére
Flag' é zjar te dighét me mire!

Jû mal' é fusha si duroni!
levisni
mos prisni
Po perpicuni édh' é mbuloni!

Mundét né ce te lém' atdhéne
te shkréte
per jéte
Armicte ndene 'ta t'a kéne?

O, kurre kjo mos cofte thene
te rojme
te shkojme
Ñe jéte nene zghédhé vene!

Me mire te vdésim per liri
ghér me ñe
per kete
Sé sa te rojme nde roberi!

Dhé sé sa ashtu Shciperia
te jéte
nde jéte,
Me mire vdékjé nga Pérendia!

BKSH

ATJÉ

Atjé poshte nden' ate brék
Neper lisat ku djélli s' djék,
Ku vésa bukur ce chkelcén
Atjé te barés me pelcén.

Atjé ku bari ghélberon
Édhé lulia ték mbréteron,
Ku bilbili me s' ka pushim
Per atjé kam ñe mallenghim!

Té pylli ku lozin zockat
Thellezat é perpolockat.
Ato me k' enda t' i skekoñ
Atjé, bésa, dua te roñ!

Atjé ték mburimi po riéth
Ndene hijé, futur ndene bréth,
Atjé me pelcén te shtrihém
Atjé te flé dh' atjé te ngrihem!

BKSH

Atjé té mali ku fryn éra
Sa mban dita, sa mban véra,
Atjé me pelcén te barés
Atjé te roñ ghér sa te vdés.

Atjé nd' at vent te Shciperise
Nd' ato mal' é ato visé
É thom mé zemr' jo mé fjale
Atjé dua shpirti t' me dale!

BKSH

Shcipetar i vertéte

hcipetar i vertéte
Dh' atdhétar i ndzéhte,
S' munt te cuhét ay
Ci mé ñe é mé dy
Kerkon te reféhét
Sé esht si deftéhét.

Ne doni te dini
Dhé nder ment t'a kini,
Tsili esht Shcipetar
Édh' i mire atdhétar,
S' duhét t' udhetoni
Kete ce te msoni.

„Sa vét' u-munduan
Atdhén' c' é ndéruan,
Émeri i tyré
Ka mbétur pascyre
É mi gur te varrit
Kane shkroña t' arit".

BKSH

Pra jû ne kerkoni
Vétén te ndéroni
U-beñ kete lutjé;
Jû ce sot é tutjé
Ce t' behi t' atille
Vini 'ré ñe kshille:

Me par' mos shekoni
Grécisht ce te msoni;
Sé ne é mesuat
Ghér me sot ch' fituat?
Ju per 'tê leftuat
Dhé vétén demmuat!

Dhé Turcisht ne doni
Prap' ce te mesoni,
Beñ bé me Pérendine
Dhé mbi ñérezine,
Sé do t' u véje kote
Kjo dhé tjatra bote!

Pa mesoni ñe hére
Po jo te perzjére,
Shcipén ghuhen t' uaj
Vétem nde tsa muaj,
Kini per te pare
Sa do t' vini mbare!

Ay esht Shcipetar
Si édhé atdhétar,
Ce do ghuhen é vét
Si ch' do ñéri i vertét',
Ci per 'te lufton
Dhé per jét' é chemon!

Pra sot mé pak mundim
Munt t' késh te math fitim,
Sé nde kete jéte
Kush s' perpicét véte,
Ate lumi é mér
S' ka as shtepi as ndér!

Jû mos bésoni tsa
Si ch' u-thone ata;
Sé Shcipja nuk' duhét
Ghuhe ce te cuhét,
Sé ata kerkojne
Mé pahir t' u-vérbojne!

Psé s' meñtohi ju pak
Édhé per kete shkak:
Vét' ju ne mos doni
T' miren t' a kerkoni,
Si mundét te huajt
T' mos u-hécin si buajt?

Hapni syte mire
Mos rini nd' éresire;
Sé ghuhen kur t' shohin
Shciptaret sé msojn'
É shkruajn' édh' é flasin
Ter' armicte do t' peltsasin!

GRÉKOMANET

Shume thone, si kam deghuar,
Sé ghuha Shcipé esht é rende
Édh' é merzitur per te shkruar
S' ka fjale c' i duhén si lende.
Keto kur i thote ñe ñéri
I huaj, faré nuk me vjén kéc,
Sé ky munt te thuash sé nuk' di
A s' i pelcén, dhé fjalen s' é héc.
Po sa turp esht per ñe Shcipetar,
Kur ay di ku eshte lére,
É me vent ce te jét' atdhétar
Vété bashkohét mé te tjére!
I-vjén ndot; s' flét per Shciperine
S' do t' i aferohét ch' do ñéri,
É deghon sé levdon Grécine;
Sé ajo i dha miaft dituri.
Thote, sé ce atjé vjén drita
Sé eshte vent i lumtesise,
Dhé mé gaz prét te viñe dita
Ce t' i ndritñe dhé Shciperise!

PUSHT

Kur shkon udhes ghith é deghon
Sé te peltsét ñe *Kaliméra*
Dhé ben sikur nuk te veshtron;
Sé trute i ka te perzjéra!
É ch' do fjale ay ce é flét
É perzjén, sé dô te reféhét
Si ñe *aristokrat* i vertét'
Ce ka dituri dhé s' geñéhét.
Po t' é pyésesh psé s' flét mire
Shcip, si ch' te ka folur jot' eme,
Psé ghuhes s' até i-vé brire
Po na thua fjale per neme?
„Oh, Shcipja eshte per bariñte
S' eshte ghuhe ce te kuptohésh,
Nuk' é marin vésh as ariñte
Dhé Shcipén kur é flét chndérohésh."
Keto t' i thote mé paturpesi
Mohon ch' do ce ka me te sheñte
S' ñéh ghuhen é vét s' ka atdhési
As mall per Shciperin' é shtreñte!
Nuk' meñtohét faré i mjéri
Sé tsa si ay sjéllin ndalim,
Ce s' dine ku munt t' jéte ndéri
Per ñe ñéri ce ka pak ghykim.
Me vent keta ce te perpicén
Ghuhen é tyré t' a ndérojne
Ata me ñ' ane ghithe hicén
É keshtu vétén é mohojne!
Si te jéte ghuhe é mjéra
Kur é perzjéjne me ch' do fjalim
É mbushin mé ghemb' édhé férra
Édh' é kane lene nde ngatrim?
Shcipja shkruhét mir' é kendohét
Po duhén ñéres mé vullnése.

Ata ce s' duan te lulezohét
Ata jane ñéres te pa bése.
Pra ter' ata ce é mohojne
Ghuhen édhé memen ce kane,
Dhé per Grécine ce punojne
Keta i cuajme Grékomane!
Keta jane turp' i atdhéut
Édhé plaga é Shciperise;
Te shuhéu nga fac' é dhéut
Sé jane bij te roberise!!

BKSH

GIROLAMO DE RADES

Emri yt o atdhétar i ndjére
Kurre mos u-harrofte 'noñ' hére.
Sé paté dashuri per atdhéne
Ac sa pak jane sot ce munt t' a kéne.
U-perpocé mé ghithe deshire
Te na deftésh si eshte me mire
Ch' do me thene ghuhe édhé atdhé
Édhé sa vlére kan' ato per né.
Cofsh i uruar o plak per jéte!
Sé ti paté ñe zéll te vertéte.
Dit' é nate mé shprése punové
Dhé Shciperin' é mjér' é gezové.
Shcipetaret ce te ghithe pa dyshim
Tyne do t' te kujtojne mé ndérim.
Dhé Shciperia sa do te jéte
Emrin t' ent per ghithmon do t' a kéte!

PASHT

DÉTETAR!

Détetar, o trim i ndjére
Nga-é lundren dréjt per dréjt
Ce te arrijme sa me shpéjt
Nde ate vent ku jam lére!

Syri loté ghith' me pikon
Sé esht mjaft kohe lark ce jam;
Détetar té ty shprése kam
Te ghéñ pacén ce me mungon!

Détetar, o djal' i mbare
Nos vono te cofsha fale,
Nga-é lundren ce te dale
Atjé ték jéshe me pare!

Déti sadô c' esht i ghere
Bashke mé ty nuk' me tméron,
Kur ti jé trim é me shpeton
Dhé per kete ti jé bere!

BKSH

Haj, haj! o burra détetar!
Sa me pelcén sa me gezon
Lundra kur shkét kur fluturon
É me shtyn atjé ku kam zjar!

BKSH

NATA É MRAM' É SKANDERBÉGUT

Mi shtrésen é tij te Mmréteréshmé
Ci ne pellast ish ghithe tuj shennrit,
Dhé pran' mé shocén te lotuéshmé
Skanderbégu 'ddékén ishté tuj prit.
É tuj thir femijen per mé ardh pran'
Per t' nramen hér' mé i u-'nnighû zân'.

Ay ci mé fame jéten é shkoj
Tuj luftûmun burrnisht é mé trimnii,
Iken, shkon sé or' é 'dékés afroj
Dhé vété n' ate bote mé lumnii!
Ah! or' é zéz', chas i shkréte si ky
Ch' mjérim i math Shcypnii âshte per ty!

Per te mramen hér' trimi hap goje
É mé fuciin ce kishté urdhenon,
Te mmlidhén Shcyptaret rrotull soje
Pare sé mé 'dék t' u flase ch' mennon;
Sé zémmra s' é linté mé u-shué
Ghér sa Shcyptart pâ i-keshillué.

PUSH

Mé i u dhân keshilla per atdhén ;
Sé rézicé te mmedhâ é kan' rréthû,
É mos m' é lén mé ngordhe por si cén
Anmict mé dhâmb' per mos m' é tsoptû !
Sé per 'te ay dérdhi ghak pa praa
É per ate Shcypnii tash vdés tuj caa !

Shcyptaret nga ghith anet u-mmlodhen
Kush kish ardh mé kâmme kush kalûmun,
É nde pellas keshtu si u-ndodhen
Mmrétit i afrohén shum' t' hélmûmun.
Lotét nga syt u-riédhin kur é shofin
Mé facén t' zbéét ac sa s' é ñofin !

Skanderbégu mé munnim ngréh kryét
É mé lot ne sy t' u-flase kerkon,
Po nnjén sé s' ka fucii, mézi i thyét
É mé mall âti te ghith i veshtron ;
„O Zot, thote, ném édhé pak fucii
Per mé mujt m' u fol bijvét te mij !

O zémmr' chil-u, dhé ti shpirt zemrô-u
T' mramen hér' keshillen per mé i u dhân,
É pastaj 'déké mi mua chô-u
Jéten per mé m' a shkurtû édhé zân'".
Trimi duert mi krahnûr si i pshtét
Shcyptarevé pastaj keshtu u-flét :

„Shcypetare ! or' é funnit afroj
Djélli per mua s' ka mâ mé shennrit
Nnjéñ tash si vdékja me ka ner thoj
É s' me lé mâ fjalet per mé i cit.
Shcypniin déri sot un' é kam nnérû
Por ce sot é tutjé ket barr' é kini jû !

Keto palle ci atjé jane mvar
Édh' ajo kordh' ci anmict i ka shû,
Mé bé t' madhé i lé kujt do Shcyptar
Mos bién n' door t' anmicvét é mallkû.
Po pas 'ddékés s' imé t' i kéni kujdés ;
Per ghith Shcyptaret ato t' jéne bés' !

O arme te shkelcyéshma mos m' lini
Vdékja te me rembéje pa meshiir,
Ti grue é femije te dashtun ku jini
Aviti pran' t' u puth mé deshiir
Shcypeniin, jû, u lé ât' é nân'
Dhé ndihme kini Shcyptaret te tân' !

O flamur shoku im i sheñtnûmun
Ti ci me ké chû ne lufta burniin,
Dhé ti shcypé ci nan' kraht m' ké shptûmun
Per mé i dhâne at lhéut liriin
Jû, sa hér' ne lufta kini mé vajt
Kujtoni sé ñi trim i u ka mmajt !

Skanderbégu hap syt édhé ñi hér'
Per mé kcyre ghith ata ci jan' rréth,
É, per te mramen é te shkréten hér'
I-mmyll syt é prap' mâ mi 'ta s' i héth !
Koken é ul, miékra po i zbarth ;
Édhé shkoj trimi ci prap' s' ka mé arth !

Kummonat tingelloin mé trishtim
Ghinnia é paduruéshmé ndziton
Per mé pâ Mmrétin, édhé pa vonim
Atjé mmlidhét ; é po can é vajton !
Nnjén sé Shcypnia c' sot ka mé râ n' zii
Dhé per jét' ka mé caa krahun é tij !

Vdic Mmréti, vdic trimi i lavdûmun
Cani malé, cani fusha t' bléera !
Tash trupi i tij nan' dhéé âsht vûmun
Dhé s' na mmét véch sé trimnia é nnéra.
Mé i u fal dhéut ku âsht vorrué
Dhé vorrit ku éshtrat jan' tuj lotué !

. . . . . .
. . . . . .
. . . . . .
. . . . . .

Cani-é burra, cani-é Shcyptare
Trimin é math ci u-dha fam' é nnér,
Ay Shcypniin é mmajti t' pandare
Édh' anmicvé i u-dha te math tmér,
Sé fill' i trimniis se tij âsht mmarûmun
Dhé Shcypnia ka mmét é vorfnûmun !

Vajto-é Shcypnii per jét' ket trim
Ci per ty 'dic mé loté t' pa shtérrun,
Ty ci mé kordh' t' dha nnér é lavdim
É n' door t' anmicvé s' te la mé bjérun !
Po si ñ' yll ishé tuj dhzidzhillué
Por tash térri, vorfnia t' kan' shué !

Sot s' ka kush ate kordhe m' é tunt
Sot s' ka anmict kush mé i debué,
Oh ! é shkréte dite psé i dhé funt
Sé nata c'ardh Shcypniin é ka mmulué
Ne kete térr te math per ghithemon
Ce Shcyptari ne robnii po ghimon !

Vjété shum déri sot kan' kalué
Nata é ghat ce é pushton Schypniin.
Ajo nat ce kur trimi âsht shué
Édhé asaj i ka chû robeniin ;
C'as ñi s' âsht ghét ket nat' m' é zhdrivillué
É mé at kordh' atdhéén m' é lirué ! !

BKSH

MALLEKIM

O ghuhe ci jé derguar préj enghell
Ci s'ké ne tere bote shembell,
Sa cenk'é bukur, dh'é békuar!
Kush s'te do, côft'i mallekuar!

Ce mije vjét ne mos u-shojté
Dhé jéten é éresires n'é rojté,
Por sot jé shkruar dhé kenduar;
Kush s'te do, côft'i mallekuar!

Psé ndzini ditet mé Grécishtén
Mé Turchén dhé Arabishtén?
Mesoni Shcipén te ndrituar
Ne mos, côfshi te mallekuar!

Per Zotn'é math é te vertéte
Ne jini atdhétare te ndzéhte,
Shkruani, flisni Shcipén te ceruar
Ne mos, côfshi te mallekuar!

BUSH

TE FALA

Te ndriteshmit atdhétar
Faik béj Konitses.

Lavderim ty, o atdhétar i vertéte
Ci mé ace ndzéhtesi penden é tunt,
Ce t'u refésh armicevé te shkréte
Sé Shcipetari nga ghumi u-shkunt.

U-shkunt... sé sot me téper sé ch'do hére
Kur syte nga ghumi mé dor' i fshin,
Shekon sé armicte c' i shkélne ne dére
Perpicén t'i kendojne: *Alilluia édh'Amin!*

Grékvé te fellicur, dhé Shcéhvé te ndyre
Ci na mohojne ghuh' édhé kombesi,
Ti o atdhétar mé te se pendes hollesi
Tere djallezit i a u ndzjér nde pascyre!

Perpara, o burre, se shume te ka hié
Chél-é penden sé Zoti te paska bere
Shkruaj te lumte, dhé defté botes se tere.

Defté te mos i bésoñe ata sa thone
Sé di shume mire si é kane zakone!

Atdhéu, burre, ci mé shprése syt' i shtié,
Émrin t'ent s'é ka per te harruar kurre
Sé di mire sé ket' émer é ka ñe... *burre!*

BKSH

LARK VATRES

Ku vété o burre ku shkon
Ku lé prinder, ku lé atdhé
Prape me s' shéh faré s' ghykon
Po iken sikur mendjé s' ké ?
Ku é shuan djalerine
Ce mjéron vent é shtepine ?

Mbe ch'ane ndjén embelsire
Dhé ka me téper bukuri
Ku shendrit djelli me mire
Sé sa ketu nde Shciperi ?
Ku ghén malé mé ac hijé
Dhé ac mburimé mé shijé ?

Ch' pelcim, ch' dashuri atjé ghén
Ku nuk te péshon as ñéri,
Ku durim' é vojtjé chfrén
Dit é nate s'ké cétesi ?
A po ron véch per pak fitim
Si bageti véch per ushcim ?

PUSH

Ku jane lotét ce t' rane
Atdhé, prinder ti kur i lé
Si, ato shkuan é vane
Pike ghak nde zémer s' ké,
Nuk te valon ajo pake
Me s' ndjén ti ghe, me s' ké flake?

Harron vent, harron dhé shtepi
Iken é me s' dukésh faré
Véch mé mendjén per tsa flori,
Vét' é dérghésh si nde varré!
Djalerin' é shuan é shkon
Dhé vendin t' ent ti é shkréton?

Harrim, o harrim i shkréte
Ti i ben ghithe zémrat gur
Ti ndan ñérine per jéte
Édh' i ri perpara si mur!
S'é lé kurre te meñtohét
Sé lark shuhét é shkrétohét!

Ti moj Shciperi é mjére
Sa durové é sa duron,
Bijte c'i kishé ñe hére
Sot per sot me kot i kerkon.
Sé te sotmet te harruan
As s' te ñohin as s' te duan!

Vuaj sa munt moj é ghore
Bése, shprése faré mos ki
Sé sot s' ghéndét ajo dore
Si ch' cé, te t' beje perseri.
Sé bijt' é tû jan' vérbuar
Nga charja c'i ka pushtuar!

Tsa nga féja dhé padija
Kane rene nde ghakesi,
Te tjére nga maresija
Léne prinder édhé shtepi.
Shkojne, ikijne boten zene
Kur te zbathur, kur te pa ngrene!

As zghohuni mor te mjére
Dhé mblidhuni prap' nd' ate vent,
Mos per boten per te tjére
Mos punoni keshtu pa ment.
Po vatren t'uaj kujtoni
Mos é lini mos é shkrétoni.

Turp per ñe komb te ketille
Te mos jét' i zoti per 'tê
Kur te tjére pa keshille
I mburon pa te shohe ghe,
Dhé vétén faré s'é shekon
Po me kéc é prish é dermon!

BIBLIOTEKA

THIRIÉ ZGHIMI

Shcipetare mjaft mos flini
Sot kur réziku ce u-rréthon,
Sé ne ndeñchi keshtu si ch' rini
Ju kur te zghohi do t'jéte von.

Armicte valle nuk' i shihni
Si perpicén t'u-rembéjne
Édh' ate tsope vent ce kini
Shtepi, ghe, é ch' do ce t'u-ghéjne?

Ata j' u shtypin pa meshire
Neper kembe u-kane mare,
Atdhéne c'é kishit te lire
Sot ata po i a bejne varre!

Ata therésin mé ze te nalte
Sé Shcipetare nuke jane,
Ata u-mbushin syt mé balte
É mé ch' do ndyresi ce kane!

BKSH

Gréket thone kémi pjése
Shcéhte prap'ashtu kerkojne,
Valle Shciptare, per atê bése
Ku duan ce t'a dergojne ?

S'esht ay ce te paren hére
É pâ driten nde ate vent,
Dhé jû ja mohoni o te mjére
Sikur s'kini as pakeze ment ?

S'esht ay ci per jû luftoj
Ce sot po gezohi nde lirim.
Psé pra sot atij ce u-shpetoj
Jû i a chperbléni mé tradhetim ?

Ne jini o te mjére si ch'thoni
Mé mesim é te cytéteruar,
Psé ahéré mé pahir kerkoni
Te rembéni ghen'é ndaluar ?

O burra chélni-u djéma
Mpréhni armete ce kini,
S'u-ngopte êdhé mé te rréma
Si armicte nuk' i shihni ?

Armet, armet, ne duart mirni
Dhé atyrevé t'u-bini mi balle,
Flamurét i a u-chirni
É mos lini as ñe te ghalle !

Per Shciperine memen t'uaj
Per 'te te luftoni pa pushim,
Sé si ch'eshte sot ajo, po thuaj
Shume kohe me s' ron, pa dyshim !

PASH

Nghallni-é, nghallni-é pra o djém
Ce te roje dhé ajo ne jéte,
Sé rojtja é saj s'esht i u-thém
Pervéch nghallja juaj é véte !

BKSH

PYÉTJÉ DHÉ PERGHIGHIÉ

Kush mbréteroj permbi ter' Asine
Mundi Gréket dhé hyri nd'Athine?
Ky ish Léka i Math burr'i ndjére
Ce si ate me s'ghéndén te tjére!
Kush cé ay c'i mundi Romanet
Édh' i perndau neper ter' anet?
Pirrua i vertéti Shcipetar
Ci cé trim é burre kordhetar!
Kush cé ay c' u-futi Turcvé tmér
Édh' i dha Shciperise te math ndér?
Skendérbéu burri i levduar
Ci nde tere bote ish deghuar!
Tsilet céne ata burra trima
Ce chkelcénin por si vétetima?
Ata ishin ghithe Shcipetare
É mé 'ta Shciperia vajti mbare!
Po sot kur t'huajt kembet i vune
Édhé Shciperise syt' i a zune
Kush esht ay ce munt te beñe ghe?
Per kete s'munt te perghighét as ñe!!

DETYRE KINI

(Kenge)

Sot ardhi dita o Shcipetare
Te punoni te vini mbare,
Sé véch keshtu atdhéu sot per sot munt t'jéte
Ghith mé ndér é fame sa te roj'é sa te jéte
O burra djéma
Sé Shciperia,
Nga juvé po prét
Nga trimeria;
Detyre kini
Si Shcipetare
Asaj t'i ndihni
Te véje mbare!
Shum' é rende eshte roberia
Kur te mungon dhé dituria.
Perandaj dhé juvé kete duhét t'a ndieni
Dhé dore préj asaj kurre te mos hieni.
O burra djéma
Sé Shciperia,
Nga juvé po prét
Nga trimeria;

BKSH

Detyre kini
Si Shcipetare
Asaj t'i ndihni
Te véje mbare!
Véch atehéré mundni te thoni
Sé fituat ate ce doni;
Lirin'é Shciperise édhé shpetimne t'uaj
Nde pacé te roni, mos u-urdheroñ' i huaj!
O burra djéma
Sé Shciperia,
Nga juvé po prét
Nga trimeria;
Detyre kini
Si Shcipetare
Asaj t'i ndihni
Te véje mbare!

BKSH

Ali pasha i Tépélénit

Ch' u-be valle trim' i ndjére
Nde bote ce ish deghuar,
Ci atdhéne s'é la t'i bjére
Armikut kurre nde duar?

Ku eshte fucia ce kish
Dhé tméri, ce s' kudzonté
Sa i forte kushdo ce ish
Kundre tija te luftonté?

Mjére, mjér' ay ce vinté
Véch t'i shkélñe kufin' é tij
Si rufé mi 'te kur binté
É pervelont' é benté hî!

Véch emrin kur i deghonté
Kushdo dridhéj nga frika,
Dhé mé sy kur é shekonté;
Oh! ahéré i binté pika!

PKSH

Syt' é tij ghith' vétetinin
Ay rrotull kur i kthénté,
Zjar édhé shkendije shtinin
Mi kedo ce i mberthénté !

Oh ! ce luân i vertéte
Armicte nuk' i péshonté
Po ghithe mé kryét perpjéte
Dilté kur mé 'ta luftonté !

Kish trimeri Shcipetari
Armet kurre s'i turperoj,
Sé kudo ce ndizéj zjari
Mé ato vendin é shpetoj !

Ali pashe, ku jé ti sot !
Ce te shohesh Shciperine,
Si renkon é si can mé lot
Armicte si é perfshine ?

Ata ce ti i largoñé
Kur hidhéshin si mizeri,
Dhé burrerisht i mposhtoñé ;
Sot kane ardhur perseri !

Thone sé s'ishé i ditur
Edhé sé beré ligesi ;
Po kjo s' esht pun' é merzitur
Kur paté ace trimeri !

Armicte ci te rréthonin
Kur punoñé per Shciperi ;
Ata nakare é shtonin
É te shitne mé tradhesi !

Perandaj sot shume jane
Ce te ghykojne si u-vjén,
Édhé ghith ñe mendim kane :
Shciperia shum' u-pelcén ;

Po névé si Shcipetare
Kurre nuke te harrojme,
Sé, si ti c'u-beñé varre
Dhé né per kete luftojme !

BKSH

LUTIÉ DHÉ MALLEKIM

I

O ciéll, djélle dhé ti hene
Yj sa jin' é kini cene,
Ci chkelcéni nat' é dite
Dhé ndani ghith miresite,
Nuk' do t' kujtoni ñe hére
Dhé Shciperine te mjére?
Ti o Zot i ghithesise
Dhé mburim i dréjtesise
Ndrito-i sot Shcipetaret
Si ndritoñé dhé te paret!

II

Ju sa jini Shcipetare
Mé ñe zemer te pandare
Behuni ñéres per pune
Esht' é udhes; s'u-thém une.

BUSH

Ghuhen jû mos é mohoni
Dhé nuk' mesohét te thoni.
Eshte turp nga Pérendia
Na céshin dhé ñérezia,
Na cuajne égersira
Te mire per maresira!

III

Malét, brighét dhé perreñte
Fushat, pyllét dhé lumeñte,
Lulét, barrat nga ch' do ane
Shpéset, kafshet dhé sa jane,
Si do te ishin nde jéte
Ne mos kishin ghuhe t' véte,
Ce t' i falén Pérendise
Krijétarit ghithesise,
Ci u-dha jéte ce te rojne
Édhé ghuhe te kuvendojne?

IV

Ch' do komb ci ron nde ket bote
Édhé shkon jéte de kotte
Pa ñohur ch'eshte dituri
Mjéshteri dhé cytéteri,
Ci nuk' perpicét nde jéte
Po shkét ghithe tatepjéte,
Ay, komb, nuk' munt te cuhét
Vdés, dhé émeri i shuhét,
Nga fac' é dhéut cerohét
Dhé nde historit s' kujtohét!

V

Si mundét jû te mohoni,
Per Pérendine me thoni,
Memezen ce u-ka bere
Ci nuk' dinté ku t' u-vere ?
Psé é lini te renkoñe
Édhe kace te duroñe,
Po prane nuk' i afrohi
Edhé ghine t' i a ngrohi ?
Ah ! per jû vuan é mjéra
Kush s' é do i u-mbyllte déra !

VI

Psé s' i kujtoni te parat
Édhé ter' ato te ngharat,
Kur jétonté Skendérbéu
Nga i tsili tundéj dhéu
Shciperine si é mpronté
Édhé vendin si é shtonté ?
Armicte kurre s' kudzonin
Sé dinin ng'ay ch' pesonin,
Sé mé pallen tij t'deghuar
Ghith boten kish frikesuar !

VII

Po sot, oh ch' fjale é ndyre
Do t'a thém sé kam detyre ;
Koha u-ndryshua faré
Dhé trimat hyne nde varré.

Ajo kohe shkoj é vaté
Shciperia mbét kécfaté,
Bijt' é sotme é harruan
Mé armicte u-bashkuan
Dhé nat' é dite punojne
Ata mé ndér t'i mburojne!

VIII

Per ghuhen ghe po t'u kujtosh
A di, or vella, ch' do t' deghosh?
Shcipja eshte per Masone
Perpara syvé t' a thone!
S'kane pake turp, as frike
Nga Pérendia ñe chike.
Shcipja, thone, na prish féne
Shkurt, te flasesh nuk' te léne.
Po Grécishtén te levdojne
Dhé mé Turchén te ghykojne!

IX

Deghomeni Shcipetare
Sa jini ñéres te mbare,
T'u thém ñ'a dy a tri fjale
Pa dalte ng'ato ch' te dale:
Te ketille Shcipetare
S' jane ghe pervéch ñe bare,
C'i fryjne cytéterise
Urtesise, diturise,
Keta jane rendesire
Dhé nde djall vafshin me mire!

X

O, kurre mos é bésoni
Sé do t' behét si jû doni,
Gréket te na urdherojne
Dhé Shcéhte te na poshtojne!
Ne kini kete deshire
Chpôrruni atjé me mire!
Hicni nde zjart te pa shuar
Lark! lark cofshi te mallekuar!
Sé, sa shume dhé zuzare
Me mir' pak, dhé Shcipetare!

BKSH

DHÉMBKE

Ce vjété i larguar
o i dashur atdhé,
Kurre s'te kam harruar
sé shum' i embel jé!

Zémra ghithe me kendon
per ty o Shciperi,
Po me téper me lengon
sé jé nde vobesi!

Ah! sa hidherimé ndjéñ
o i bukure vent,
Hire as ghekundi s' ghéñ
kur tyne te perment!

Te falura te dergoñ
ce ketu o atdhé,
Dhé ghitheñe te kujtoñ
sé bir ti me ké!

BKSH

Per ty shume me vjén kéc
o i mjére atdhé,
Pra mendjén téjé s'é hec
sé zémra nuk' me lé!

BKSH

PUNONI PA-PRÉRE.

Bere per Carkun „Shprésa.“

vasha dhé jû djém te riñ
Jû Zoña dhé jû Zoteriñ
Te ghith sa kini ñe cellim
Mblidhi, bashkohi pa vonim.
Éja ! punoni pa-prére
mé shprése
mé bése
Per Shciperin' é mjére!
Sot Shciperia po ju therét
Si bij te saj te vertét'
Ghithe ku jini é sa jini
É per 'te mall ce kini.
Éja ! punoni pa-prére
mé shprése
mé bése
Per Shciperin' é mjére !
Malesor' é fusharake
Cytétar' é fshatarake
Kendoni mé zê te nalte
Kete ghuhe c' esht si mjalte.
Éja ! punoni pa-prére
mé shprése
mé bése
Per Shciperin' é mjére !

BUSH

Jû mjéshter' é trégetare
Punetor' é ushtetare.
Kudo ne cofshi é me ch' do chip
Shkruani, flisni vétem Shcip
Éja ! punoni pa-prére
mé shprése
mé bése
Per Shciperin' é mjére
Ghithe jû burra Shcipetare
Ce jini ñe fis é ñe fare
Ne kini te ghithe ñe zémer
Mbani-é lart kete émer.
Éja ! punoni pa-prére
mé shprése
mé bése
Per Shciperin' é mjére
Ju malé ce ghélberoni
Dhé ju zogh ce lighironi
Kurre, kurre mos pushofshi
Shciperine ghér mos zgofshi.
Éja ! punoni pa-prére
mé shprése
mé bése
Per Shciperin' é mjére

BUSH

VAJTIM

Ch' ké moj zémer ce renkon
Loté héth é nuk' pushon ?
Ch' ké or bilbil ce s' kendon
Dhé ti pyll ce po ghemon ?
Psé keshtu jû vajtoni
É dhembjén nuk' m'a thoni
Po héshtni dhé duroni
É nde trishtim lengoni ?
Valle nuk' kini liri
A po s' kini bukuri
Te gezohi perseri
Si mê pare dhé tashi ?
Kur te ghitha sa rojne
Jéten tyré é ndrojne
Dhé kurre s' é hélmojne
Po nghallén lulezojne ?
— Ah, o i mjére ñéri
Si kuvendon keshtu ti
Dhé shkakun faré s'é di
Kur bashk' mé né dhé ti ri ?

Kjo gheme ce na ka ghét,
Valle nuk' eshte vertét
Sé mem' é varfer ka mbét
É véteme sa u-trét?
— Édh' une tere keto
Mé syt' é mij po i shoh
Si vuan é ghor' ajo
Ce as une mê s' é ñoh.
Po mos jini nde dishprim
Ju kendoni mé pelcim,
Sé koha ardh mé vrapim
Ce te dale nde shpetim!

BKSH

PER SHCYPNIIN

Per Shcypniin é dashtnumûn
ci ka mmét n' vorfnii,
Djélmt' é saj n' kamm' jan vûmuŋ
per mé i dhân' ditunii.

Sot âsht dita é pritun
bijt' é saj sa mé munt,
Nga térri per m' é citun
nga ghumi per m' é shkunt!

Nâna é jon' é mjéra
ci ne mjérim ghimon,
Ajo na therét per héra
t' i japim ch' i mungon!

S'ka pune m' é shejtnûmum
per atdhéén kur lufton,
Si dhé per t' lulezûmum
ghuhen c' é kuvendon!

BKSH

Ch' do Shcyptar ci nuk' men non
Shcypniin mé nnérué,
Po annikvt i nnihmon
âsht ñi i chmênnué!

Ay s' âsht ñéri mé ment
kete duhét m'é chpoor,
As mé hy mé 'te n' kuvent
sé ky âsht tradhetor!

BKSH

SHCIPETAREVÉT

Sot esht dita o Shcipetare
Te rembéni pushken pa vonim,
É mé kudzim te ndisni zjare
Ce te shpetoni nga ky mjérim!

Shciperine jû vét' é shekoni
Si po renkon ne roberi,
É jû as ñe nuke kudzoni
Si ch' ishté t'a beni perseri!

Tere bota thoni sé chudités
Mé trimerin' é Shcipetarit,
Fjale te kotta sé s' goditét
Kur atdhéu eshte buze varrit!

T' tjéret ng' armicte ce t' i mproni
Jû vini kordh' é palle nghéshur,
Dhé Shciperine me s' é veshtroni
Po vriti, a kthéhi te chvéshur!

BKSH

Jû tere boten é rrotulloni
Duk' i ndihur kujt do per shpetim
Por atdhéne, kete s' é kujtoni
Po é lini per jéte nde harrim!

Per ate dhé, ku pane djéllin
Ghith' kombet perpicén dit' é nate,
Permbysin boten édhé ciéllin
Ce t'jéte é tyré gher' é ghate!

Valle jû ce kur po luftoni
Duk' u-hécur tjatër hundësh,
Ku i kini te mirat ce thoni
Sé fituat kur duallte mundes?

Mos mendoni kurre 'noñ' hére
Sé i huaji u-ka per te shpetuar,
Si ch' bete jû per te tjére
Ay s'esht i marr' as i terbuar!

Zghohi, ngrihi édhé malét zini
Flamurin t'uaj atjé t'a ngrihni,
Mé shcipoñen é si ch' é kini
Atjé t'jéte; armikut t' i bini!

Hutat dhé plumbat te kertsasin
Ghith malét sa jane te tundén,
Te huajt per Shcipetaret te flasin
Édh' armicte nga frika te shkundén.

Jû Gége burra te vertéte
Dhé jû o Toske te pa-vdire,
Hidhuni bashke si shighéte
Dhé benéni atdhéne te lire!

Mblidhi pra, bashkohi mé bése
Ndene flamur te Shciperise,
É sitsilido per 'tê te vdése
Si trim, per fitimn' é lirise !

Atehére do t'kini lavderim
Sa te jéte kjo bot' é ky dhé,
Te ghith do te thone mé gezim
Sé kini ghak te t' madhit Skendérbé !

BKSH

Naim béj Frasheri

Si ñe yll shum' i chkelcyér
Ci naten ndrit mé embelsi,
Dhé chon drite te pelcyér
Kudo ce eshte éresi.

Por si lulé bukur chfacur
Tere kopshtin ce zbukuron,
Natyren duk' é kenacur
Mé éren é saj ce leshon.

Ashtu dhé Naimi ndriti
Mi ciéllin é Shciperise,
Éresiren i a ngriti
Ghuhes édhé kombesise.

Caj-é Shciperi é mjére
Lulén é bukur c' u-shua,
Ate vjérshetor te ndjére
Ce kendoj trimnit' é tua!

BKSH

Mé ñe ze te pérendishme
Ty te levdoj miresite,
Te dha jéte te dobishmé;
Te solli ñe rézé drite!

Mé ñe mall te pa shteruar
Te nghalli é te dha jéte;
Per ghuhen duké punuar
Si Shcipetar i vertéte!

Perandaj kombi i tere
Can mé loté pa pushuar,
Per sherbimét c' i ka bere:
Per jéte duk' é kujtuar!

BKSH

KESOLLÉS

kesollé ce me rité
nde vogeli
Dhé nde djélle ce me cité
mé embelsi
Psé ti jé ac' é gezuar
plot deshire
Édh' une ac' i hélmuar
pa meshire ?
Valle tsili t'jéte shkaku
mé te vertét,
A po mua m' u-kthyé ghaku
sé t'lashe vét ?
Psé as ghekundi nuk' é ndjéñ
ate shijé
Kur neper cytété te mbedhéñ
syt' i shtié,
Po me dukét ñe ghe é thate
édh'é vshtire
Dhé jo si ti ku ce me nate
é pa gdhire

BUSH

Pa ngritur é pa fshire syte
ghéllat deghon
Dhé pa pérenduar yjte
bilbili kendon !
Ku ghén ace embelsire
dhé bukuri
Une thém as s'ka me mire
per ch' do ñéri !
Vasha brenda kur kendon
mé t'holle zê,
Dhé djali jasht' é perghon
t'i thote ghê !
Plécte rréth vatres kur rine
te meñtuar,
Pastaj shtrihén han' é pine
te gezuar !
Édhé grate lajn'é cépin
holle mvéshur
Chupa foshñes i tunt djépin
duké céshur !
Jashte per rréth mal' é shkembiñ
ghithe nde ré,
Édhé perreñte si gherpriñ
rrotull i ké !
Poshte dukét lum' i ghere
ce s'ri me vent
Po neper grur' é tershere
rjéth si erghent !
Ah ! sa me pelcén o kesollé
kur te kujtoñ,
Sé ti nde shpirt gaz me mbollé
dhé dot s' t' harroñ !
Sa mall per ty me pertrihét
sa dashuri,

As mendja nuk me shtrihét
s'kam cétesi !
Sa te dua o nature
kur te shekoñ
Pa ty jam si i semure
édhé dot s' roñ !
Pra, lark o cytét préj méjé
dua liri,
Sé shijé s'kam pare préj téjé
as bukuri !
Véch ti o kesollja imé
vét ci' ké mbét
Ch' do bukuri é gezimé
kurre s'i humbét
Dhé ti djélle ce me ngrové
rézét i cit
Prap' me gezo si ch' me gezové
bukur me ndrit !

Per atdhéén

Pro patria...

Atdhéu préj anmicsh ish rréthué
Kur nâna tuj pertsjéll birin é vét,
É pershennosh ghith tuj é békué
Nga lufta per mé u-kthyé mé shnnét.
I-uron nga zémra prép per mé ardh
Burrnisht mé luftû, armet mé i zbardh!

Ciélla préj térrit kudo ish mmulué
Dhé érnat frynin ghithe tuj perpjékun,
Valat é détit por si t' terbué
Ghith shka anes mmrênna tuj hjékun.
Katunni i tân' ne trishtim ish bjérrun
Sé ch' do shtepi kish mmét si é shtérrun!

Burrat kânn-é-kânn te armatosun
Kishin dal mé hov anmikun m'é prit,
Mé vullnése mé shprése te reñosun
Mé mos é lén kurrmâa kryét m'i cit.
É, nân' é biir mé lot n'syy jan' 'dâmun
Sé nuk' diin' mâ n'jét' n' kan' m 'u-pâmun!

PUSH

Oh, lufta kish fillué mé ghaksii
Trimat si luana tuj luftûmun,
Pa kurtsyé vétén per ñ' atdhési ;
Véch vênnin é vét per m' é shptûmun,
Te 'dékun binin mé zémr' t' gazmûmé
Sé kan' shellbué atdhéén é mjerûmé.

Anmict te dobetué nga dishprimi
Jan' chperdaa si ujku ci 'dan bérrat,
T' hupun, te munnun hicén kah kushtrimi
Tuj lanun ushtriin t' thérrun si shcérrat.
Sé trimat kishin luftué per m'i nnjékun
Dhé burrnisht 'dékén ishin tuj é prékun !

Lufta é tmérueshmé kish pushué
Trimat tuj gatûmnn per ne shtepi ;
Kur te 'ddékunit mé i numurué
Shokn' é dashtun mâ sé pan' perseri.
Kish 'ddék i mjéri mé pall' ne door
Anmict jasht' atdhéut per mé i chpoor !

Nân' é tij n' déér ish ghith tuj pritun
Birin t' vétum per mé é percafué,
Ate c' é kish tash burr' te ritun
Pléceniin per mé i a ammeltsué ;
Nat' é dit ghith ate é kish n' mênn
Mé é shtrengué dhé ñi hér n'préhên !

Por kur shokt n' katunn prép' jan' kthyé
Plaka tuj pvétun per birin é vét,
É ata pa mir' punen i a deftyé
Mé i thân sé n'vênn t'luftes kish mmét
Kuptoj é mjéra sé i biri kish hup
Tuj luftûmun burrnisht mé arm' ne sup !

Grue é mjér' yt bir 'dic tuj luftûmun
Tash ti ké mmét vét ne plécenii,
Ce sot s' ka kush per te nnihmûmun
Jéten t'anné per m' é shkue n' cétesi,
Dit' t' rânna édhé mé t' veshtiir
Ké mé hjékun kur ate jé tuj é thiir!

Oh! n' hélmim per ket kurre s' kam mé ranun
Mâ mir' âsht mé rrnué n' vobesii,
Ne coft sé kjo nga Zoti âsht é thanun
Sé im bir ka 'dék mé nnér é lavdi!
Sé s' ka ghâ mâ t' shejtnûmun mi ket dhéé
Kur ñi ñéri 'dék tuj luftûmun per atdhéé!!

BKSH

FUSHORÉ

BKSH

BKSH

FRORI

Shkurti shkurton uret
Marsi mér lékuret.
(É popullit).

Nuk' eshte as dimer as prendvére
ky dit-shkurter ce cuhét Fror,
Po esht muaj si shume te tjére
dhé ka ndér t' jéte vjérshetor;
Ketu te gezon é zémren t'a chél
kur ciélli bukur mi ty césh,
Pastaj kthéhét, mvréjtét djélli me s' dél
édhé nde trishtim do te jésh!
Djélli hére hére bukur chkelcén
édhé hena si vashe césh,
Thua sé po prendvéra tashi vjén
dhé mé dimrin ti po percésh.
Ah! sa bukur édhé flé nde cétim
ghum' i embel te rembéu,
Po jashte vériu fryn mé terbim;
koha fléten na é kthéu.
Ah! ch' muaj i rrém' édhé geñéshtar
sot dbore néser djéll' é shî
Ciélli siper tashi esht flag' é zjar
pastaj kembéhét perseri.

Ketu déti dukét c'esht i cétte
dhé détetari po kendon,
Po kur ñe vale vjén c'tatepjéte
atij ânién j'a thrimon !
Debor' é akull zun' é po trétén
ujerat riédhin mé ndzitim,
Rekéte mfryhén; véch diku mbétén
péllghé te vogla pa théllim.
Bujku mé gaz ben gati parmenden
céhte, végla é ghith sé ch' kâ,
Si ghahtari c' mér pushken é lenden
ce i duhén kur dél per ghâh !
Aty zoghte ndzjérin tsetserimé
ñe ze te embel pa kuptim,
Mé mall présin véren mé gezimé
t' j'a nisin kenges pa pushim.
Edh' atâ ghith si ñérine ndjéjne
sé s' esht êdhé koh' per kendim,
Po ñe shprése i ben te ketséjne
jashte folése pa durim !
Vasha ci é malleshmé po kendon
nd'ate kesollé pa shenim,
Mé deshire nga déra po kcyron
ghéthin é thate mé mfshénim.
Atê, ajo per dite é perment
sé ay mallin i kujton,
Kur djali buze céshur nd'ate vent
mé mall shpirti é percafon !
Frori sado c'esht i veshtire
dhé shume hére na geñén,
Po ghith ka édh'ay ñe te mire
ce ch' do ñériut i pelcén.
Sé, ce kur hyn é ghér sa te dale
mé ghith c'eshte ne zemerim,

S'ka ch' te na beñe sé esht i *chale*
é kjo é shtié nde terbim!
Po, ch' do ñéri Frorin te viñ' é prét
sé ay na sjéll véren pas,
Dit' te bukura, gezim dhé shendét
é ch' do te mire na é cas.
Dhé pas trishtimit, ce miaft na pushton
dimri i rende mé merzii,
Vjén véra é bukur ce na gezon
mé shpirt é zémer nde lirii!

BKSH

PUNETORI I MIRE

Ngrihét ce me nate
Pa dale mire djélli,
Mér céh, édhé shate
Pa u-zbardhur ciélli.

Nd'are vété mé gas
Punon mé deshire,
Dhé dréka si u-cas
Hâ édhé pi mire.

S'trembét kur fryn éra,
As shiu kur pikon ;
Sé ketu esht vléra
Per ate ce punon !

Punen si é mbaron
Ce djérsa i riéth,
Dhé djélli pérendon
Ay véglat i mbléth.

BKSH

Mbremanét nde shtepi
Nga puna vjén chlodhét,
Mér femijen nde ghi
Édhé hâ ch' te ndodhét.

Vréshten é ka kujdés
Bagetin' é ushcén,
Pa mjéll nuk' ri nde thés;
Te ghitha mir' i kthén.

Vjéshta kur afrohét
Ay shtepin' é mbush,
Dhé ri é cétohét
Prane zjarit mé prush.

Sa gezim ay ndjén
Kur ka sé ch' i duhét;
Dimeri i pelcén
Édhé kurre s' huhét.

Puna eshte ñe ndér
Per ch' do ñéri mé ment,
Pertimi eshte vrér
Pa fjale pa kuvent!

BKSH

Ardhj' é prendvéres

Sa shum' é kandeshmé édh' é bukur
Jé o prendvére nde te dukur!
Ti kur lulezon
Ňérin' é gezon
Dhé natyren é tere é chél
Boten an' é mb' an' é perkedhél!

Bariu mé gazmend rréth shekon
Kur ghéth' é pyll bukur lulezon!
Mé zemren plot gas
Mér kopéne pas
Mé fyéllin duké kenduar
Vété é shtrihét i cétuar!

Ketu ňe djale mé mall kendon
Kopshtin é ndréc édhé é nderton.
Ah! sa i pelcën
Kur syte i kthén
Édhé shéh te dashuren é vét
Kur ajo me émer é therét!

RKSH

Micesi, dashuri, a po ch' do;
Prendvéra i ka tere keto !
Largon ch' do trishtim
Dhé sjéll ghith gezim.
Kurre s' eshte ñériu ne merzii
Kur ghéndét nde ace bukurii !

BKSH

NATYRA

Ah ! sa me pelcén bari
Dhé mburimi si ari
Ce riéth tatepjéte
Mé nga dal' édh' i cétte.
Dhé zoghte kur cendrojne
Ner déget é kendojne
Mi druret mé flété shume
É s' te léne nde ghume
Oh ! sa bukuri kane
Kur jé édh' i shéh prane !

Brighét bukur stolisur
Ghith mé lulé céndisur,
Pylli kudo mé hié
Ce te k' enda kur bié,
Dhé flétet kur perpicén
Syte ce atjé s' te hicén.
Ac esht é pelcyér
É bukur pa deftyér
Natyra kur pertrihét
Eshte pune ce s' mfshihét !

BISH

Hena kur neper brighét
Dél si dylle ce dighét,
Dhé ndrit mé embelsire
Ch' do ghejé i jép hire.
Naten é ben te arte
Mé dritene te zjarte,
Réhte, si édhé ch' do vent
I-nghyron ghith mé erghent!
Sa pelcim sa bukuri
Ce s' é mohon as ñéri!

BKSH

PRENDVÉRA

Se largu ñe ér' é fréske po fryn
Ciéllin é ben t' kaltert, dhé réhte i shtyn;
Malét kudo chélén lulezohén
Kodrat, brighét chfacén édhé ndrohén.

Kumbullat, geshtéñat, cershite
Dushku, robulli é laithite,
Pémet te ghitha bukur pertrihén
Mé flét' é lulé ték zoghte mfshihén.

Ketu bilbili kendon neper ghéth
Melliña é gezuar ri mi bréth;
Dhé dellendyshja rréthon, flytyron,
Cycéja dég' mi dége vét' é cendron,

Grérat é ghinkallat faré s'pushojne
Ketu tsertserijne aty kendojne;
Sa embelsi sa gas i pa deftyér
Oh! kjo jéte sa cenk' é pelcyér!

BKSH

Femijet lozin mé te perléshur
Mi bar hidhén, kertséjne duk' céshur ;
Dhé shcérka pas délés po blégerin
Dhé s' pushon ghér sa pas nuk' é arrin !

Bujku i gazmuéshme po kthéhét
Mé shpirt te kenacur ce s' deftéhét ;
Dhé céhte te kullosin i leshon
Mé hire shtrihét Zotin lavduron !

Perreñte mé mfshénjé ushetijne
Pikat ce hédhin si erghent ndrijne,
Dhé ujitin ketu ñe lulé kucé
Me téj tsa violtsa mé burbucé !

Ah ! ja dhé licéni i kulluar
Si dridhét nga éra i t'holluar ;
Por si zémra ci per ch' do pikllim
Gezohét a trishtohét mé vrapim !

Ah ! sa é bukur jé o prendvére
Sa gazmend sjéll, sa gherra mé vlére
Ketu lodre, edh' atjé dashuri ;
Ti jé jéte shprése per ch' do ñéri !

Brédhi, robulli, lisi
Madheshtorisht é prékin,
Rufén' mi 'ta ce krisi
Déget pa t' i perpjékin.

Véch ahér' uñén, tundén
Kur shiu mi 'to bié,
Dhé pikat poshte shkundén ;
Bari lagét mé shijé.

Dhé ñériu mé hire
Shekon shiun ce bié,
Édhé ndjén ñe deshire
Kur syte jasht' i shtié.

Zemra shum' i gezohét
Édhé Zotin lavduron,
Shpirti i tij cétohét
Kur dél ashtu si shpréson !

BASH

Brédhi, robulli, lisi
Madheshtorisht é prékin,
Rufén' mi 'ta ce krisi
Déget pa t' i perpjékin.

Véch ahér' uñén, tundén
Kur shiu mi 'to bié,
Dhé pikat poshte shkundén ;
Bari lagét mé shijé.

Dhé ñériu mé hire
Shekon shiun ce bié,
Édhé ndjén ñe deshire
Kur syte jasht' i shtié.

Zemra shum' i gezohét
Édhé Zotin lavduron,
Shpirti i tij cétohét
Kur dél ashtu si shpréson !

BKSH

Mbremanét nde fshat

Nata afron é embel é pelcyér!
É mé ñe pluhur te holle é mbulon
Fshatin si édhé natyren c' é rréthon;
Mé tjater nghyre duk' i perkthyér!

Me hire ngrysét, kudo eshte cétim
Ñérezit nga puna zen' é po kthéhén,
Bagetite shtrihén é rekelléhén
Te lodhura nga i te se dites mundim.

Flytyrat faré me s' dukén neper ére
Thelleza, pupeza, bilbili mfshihén,
Ce t' gazmûmé dita kur chkrép te ngrihén,
Prape te rotullojne si kurdohére.

Ja édhé hena midis brighevét dél
É madheshtorisht ndrit mé embelsire,
Malit, briñes, dhé fushes i jép hire
Boten mé ñe mfshéhtesi é perkedhél!

BKSH

Éra fryn é gadalte ; me tutjé buchét
Ne més te pyllit ñe ze kemboré
Ku é gezuar mé lopen per doré
Po vjén chupa é kenacur sé é ghét !

Mi fshat s' dukét véch sé tymi ci rréthon ;
Grate t' pervéshura gatitin mé ndzitim
Darken, per punetoret ci mé kendim
Vijne nga puna djélli po sa pérendon !

Oh ! sa pelcim ndjén kur mbrema afron !
Kur éra é lipés perndahét per réth,
Melleza, shélgu a po me tutjé ñe bréth
Kur nde t' érret shkasin, hena i nghyron !

Tashi éresir' é plotte nde fshat u-be
Dhé pacé tere ñérezin' é pushton ;
Véch andéj ketéj nga 'noñe ze deghon
Kur te dashure mfshéhtazi flasin ghê !

Bota é tere eshte nde cétesi
Kudo héshtjé mbréteron kudo pushim,
Natyra chlodhét, ce, néser mé pelcim
Prape te chélét t' jéte nde bukuri !

Ah ! sa pelcimé ka fshati sa enda
Mé bukurite ce é rréthojne,
Dhé ace gherra ce te gezojne ;
Ce kurre s' munt t' i trégoñe penda !

FLYTYRA

O flytyrz' é vogel é kraheshkruar
Sa é kandeshmé cenké nde te dukur,
Kudo ti ce shkon duké flytyruar
S'ka ghe m' é pelcyér, s' ka ghe m' é bukur!

Flytyre, ti kur vjén ghithe gazmend sjéll
Natyra césh, dhé bota esht nde gezim,
Sé ti vogeloshé dimrin é pertsjéll
Dhé né, na mbush zemrat mé mall pa-mbarim!

Ghéthi mé ty ka shijé kur mbléron
Si dhé pylli kur eshte nde lulezim,
Kur, é léhte si pupull mi 'to cendron
Dhé flétet é malleshmé i puth mé défrim!

Flytyre, ci é gazmuéshmé rréthon!
Dhé férr' é ghémb nuke te tremb kur é shkél,
Po mé pelcim ri mi 'te édhé kcyron
Pastaj sulésh lot mé shokén ce te dél!

PASH

Flytyrô bukuroshé na pergezo
Perkedhél-na mé ate embelsire,
Si ch' perkedhél lulét kur cedron mi 'to
Dhé fushes kur mé lodrat i jép hire !

BKSH

SHÉLGHÉT

O shélghé ce tundni kryét
Kur éra midis jush pershkon
Ce perroji fytyrra nghyhét
Kur pran' i gadalte kullon,

Ju péme ce zbardhelloni
Mé lulét c' u zbukurojne,
Édh' ére t' embel ce choni
Boten rréth ce t'a hijésojne,

At' hécjé ce me s' é sosni
Ňérine ashtu c' é kapni,
Nde pamjé ce é chvendosni
Dhé shprése nde shpirt c'i hapni,

Nuk me thoni ku é ghéni
Valle juvé kete fuci,
Ce ch' do zemer é defréni
Sikur i shtini mé maghi?

PASH

Zoghte mé sa embelsire
Mi déget rine pa pushim
Dhé kendojne ghith mé hire
Ce te prapsin nga ch' do trishtim!

Dhé mburini ce murmuris
Kur shkon i cét' i kulluar,
Manushacét ci me ch' do vis
Perhapin ére t' uruar,

Keto gazé dhé kendimé
Dashuri plot mé vjérshesi,
Valle nuk jane provimé
Sé jû perndani lumtesi?

Perandaj dhé ñériu ndjén
Ac' ende nen' jush kur bié,
Kur éra lulét i rekellén
Édh' é perkedhélin mé shijé!

BKSH

BARIU

Impshtjélle mé roben, édh' i mpshtétur mi gur
Mé syt' te mberthyéra é mendjén te cétte,
Kcyron natyr' é malét ce jane rréth si mur
Pa te ndjéje a te dije tjater ghe nde jéte!

Chkrép dita; ay nghitét brégut perpjéte
Édh' i lumtur ndjéhét kur nde majet cendron,
Ce posht' kush é shéh, dukét ñe sheñt t'jéte
Kur djélli mi 'te rézét é para i chon!

Kcyron! veshtrimi i tij i humbur per rréth
Vétem nga hére kur dhénte i largohén
Vershellén si i chpuar; kur 'noñe ghéth
Duk' u-tundur, tremp ñérezit c'i afrohén!

Burimi riéth prane; ay ri édhé hâ!
Permi natyre mbréteron é permi bote
Bukurin' é ñéh, ligesi nde zemer s'ka,
É per ch' do madhesi ay esht'i ftohte!

BKSH

Kur natyra esht ne zemrim ce malét i tunt
Ciélli i érret ghemon é vétetin,
Ay s'trembét, as s'parpsét po duron sa munt:
Si ushtari kur ñe luft' é rébte chkrépetin!

Po kur koh' é natyre jane nde bukuri
Édhé bilbilet j'a thone neper bréth é lis,
Oh! mé gaz ahér' ay shtrihét, ce t' i késh zili
Si mbrét mi front, édhé kenges i a nis!

Kendon, kendon dashurine c'é ndjén
Édhé chmallét atjé vétem nde fillerim,
Si véttari ci nde celiét kur shberthén
Me lutjé té Zoti, se hér' esht nde hidherim!

É kur duk'u-ngrysur djélli rézét i shtié
É nghyron majat é malevét mé embelsi,
Ay nga dalé zbrét édhé fyéllit i bié
Ghér sa te dashuren mé mall é has perseri!

DIMERI

Pylli me s' ghélberon
sé nga flétet u-shkunt,
As éra me s' pushon
po shpésh déget i tunt.

Dellendyshéja shkoj
si na gezoj n' vére,
Ah! dhé cycia pushoj
vajti nde shketére!

Flytyrat me s' véne
neper lulé mé cendrû,
Ch'do gazmend é léne
dhé trishtim i ka pushtû!

Hena nuke shendrit
sé réht' é kan' mbulû,
Véch nga hér' rézét i cit
por si vash' é turpnû!

BKSH

Éra fryn, bié shi
vériu vershellén,
Vjéshta iken tashi
dhé dimri mé vrap vjén!

Dbora floké floké
te ghitha i mbulon,
Si kur s' jé ti o toké
sa bukur zbardhellon!

Zoghte toghé toghé
per mé kerkû ushcim,
Zihén neper shtoghé
kur hane mé ndzitim!

Dbora zbardhi malin
dhé fushen tatepjét',
Ñérezit me s' dalin
dhé ruga esht é shkrét'!

Kudo eshte pushim
dhé héshtjé mbréteron,
Véch vériu mé terbim
perpjék édhé rezon!

Hohô! pusho o véri
miaft mos vershellé,
Ku cé éts' perseri
dhé prape mos u-kthé!

Prendvéra per mé ardh
mé dit te gazmûmé,
Fushen mé na é zbardh
mé lulé t' békûmé.

BKSH

Éja pra o lulé
ce ritésh nde vése,
Ti nga ciéll u-sulé
per mé na prû shprése!

BKSH

MENDIMETARÉ

BKSH

BKSH

ÑE ENDER

O Zot! valle ch' ender te jéte kjo
Ce mua m' u-refyé sonté,
Sikur édhé tashi mé syt é shoh
Kur nde ghume zemren m'a derptonté!

Pashe sé kisha vajtur nde ñe pyll
Édhé neper malé po shetitña,
Permi mua ndjéña sé ñe yll
Me dréjtonté, ata kur i nghitña!

Ah! ch' bukuri ishté pa mase:
Kudo ce shkélña édhé ték viña,
Ce kurre s' bésoñ kjo te me nghase
Bilbile kendonin dhé melliña!

É keshtu kur duké u-shetitur
Majes se malit u-aferuash,
Ndjéñ ñe ze shume te chuditur
Ci me theristé: O, sa do t' vuash!

BKSH

Dhé s' me linté as nde cétesie
Te kcyr, te shoh, édhé te gezoném,
Sa ghéndém nde kete bukurie
Sé pastaj miaft do te hélmoném.

Kthéva syte rrotull me ate chas
Po as ñéri s' pashe prane méjé,
Cendrova, perghova dhé ghe s' m' u cas
As lark, as afer, as te vij' a te véje!

Ah! sa tmér te math ndjéva kur me tha:
Nghit-u, nghit-u atjé ku esht mê lart,
Te shohesh boten mé ghithe sé ch' ka
Ce s' ké mé pâ ghér sa te hysh nde vart!

Oh! ch' lartesire, ku te nghitém?
Zémra po me dridhét, ch' maresire,
Ciélli esht afer, véte habitém
Dhé dyshoñ valle do t' arriñ mire!

Perpicém, perparoñ mé ghith fuci;
Prapsém mé tmér é frike kur veshtroñ
Sé jam vétem fill pa ndoñe ñéri
Ce t' me shpetoje, ghe po te pesoñ!

Nde majet faré po sa arriva
Hodha syte pa durim tatepjéte,
Po per ñe hére ndjéñ sé ngriva
Kur pashe sé ch' eshte kio jéte!

Pashe bageti dhé ñérezine
Si perpicéshin per kete rojtjé,
Te uret ishin per bégatine
Édhé per 'te duronin ch' do vojtié!

Ñeri shtynté tjétrin s' di persé
Vellai hanté te vellane pa prâ,
Tsa réndin perpjéte pa vene 'ré
Dhé poshte binin shume nga keta !

Ketu dukéj ñe sé urdheronté
Ce shum' i faléshin mé uñesi,
Me tutjé ñe tjater po renkonté
Dhé loté hiththé : per sé kush é di !

Burra é gra, djém é vasha ishin
Tsa therisnin, édhé tsa lengonin,
As une nuk' di keta sé ch' kishin
Sé t' tjére defrénin é kendonin !

Me tutjé te tjére po luftonin
Dhé armet perpicéshin mé zemrim,
Ghakrat rjithnin édhé mbulonin
Rugat, sikur kurre s' kishté mbarim !

O ch' mfshénjé ! sa dridhjé ce ndjéva
Kur pashe mé sy ch' eshte kjo bote,
Duarte mi koke i perthéva ;
Dhé perghoña zeri ch' do t' me thote.

Mbéta si i habitur é thashe :
Valle persé kac keta mundohén
Do t' a kéne mendjén ac te trashe
Ce ñeri tjétrin te mos kupetohén ?

Tsili do t' jéte shkaku i vertéte
Ce kurre te mos jéne nde pajtim
Kur kjo bote ka, é munt te kéte
Per te ghithe sa rojne ñe cellim?

Bota sot eshte ndryshuar shume
Dija édhé drita é kan' nbuluar,
Sot ñériu me s' eshte nde ghume ;
Pra, keto ce shoh kane per te shkuar!

Ah! jé lark nga é vertéta o ñéri,
Me thote zeri ci pas po ngét,
Shkoj ajo kohe é me s' vjén perseri
Sot vellai te vellane po é shét!

Ñe padurim é pushton ñérine
Sépsé kerkon bégati pa mase,
Per ato, ay dérth ter' fucine
Édhé nde vrasjé munt ce te shkase.

S' é pé si mundohét é si chirét
As per fé, as per vella nuk' mendon,
Po mé te tjéra ce s' duhén mirét
Mé punera ce Zoti s' urdheron?

Por si kafshet te égra mé terbim
Ce hidhén kur i shtrengon urija,
Ashtu dhé ñériu shtyp per lakmim
Ñeri tjétrin mé duart é tija!

Kjo luíte c' é shpié nde cytéteri
Mé ac' vojtjé per te se rojtjés ushcim,
S' esht ghe tjater per boten ce thua ti
Pervéch ñe ndjékjé per t'asaj shkurtim.

Jo kurre, thashe, bota une thém
Ka perparuar nde ch' do mjéshteri,
Ce te t' i deftéñ fuci s' do te kém
Kur keto munt t' i shohesh véte ti.

Perparim, perparim tashi kudo
Vété, vjén, udheton a po ch' kerkon,
Ñériu sot u-zghua domosdo
É sado perpara ghithe po punon.

Kur malét édh' ato zjar vjéllin
Kur réhte perpicén mé bumbullim,
Yjte ci ciéllin rréth é rréth é mpshtjéllin
Te ghitha sado trazohén pa pushim!

Kur djélli sjéll mi dhé thatesire
Dhé déti valat i ngréh mé terbim,
Dhéu kthéhét kembéhét pa meshire;
Pra, dhé ñériu ka ghak é do chfrim!

Ah! i shoh te ghitha keto pune
Po mire si me dukét s' me kupton,
Per gherrat ce po t' i thém ty une,
Zeri prap' ne véshe me tingellon.

Djélli, hena, yjt' é ghith sa jane
Dhéu mé bégatite pa mase,
T'ghitha préj Zotit ñe cellim kane
É nuk' ndryshohén ch' do ce te nghase!

Dhé ñérine nde bot' é ka bere
I-ka dhene mendjé édhé ghykim,
Ce ch' do ghe mé dore ce te zere
Per jéten é tij te jéte fitim!

Sheko mbléten si punon pa réshtur
Mé ch' mjéshteri vété é shtryth lulét,
Askush s' é ndjén po ghith duké héshtur
É ngarkuar prape me vent sulét!

Veshtro dhé ghithesin' é pa ane
Sa bukur chfacét nde hapesire,
Édh' ace sheñ' é punra sa jane
Natyres c' i japin embelsire!

Édhé ñériu te punoñe sa munt
Po jéten t'a shkoñe plot dashuri,
Sé atehére thém askush s'é tunt
Po fortsohét dhé ron nde lumtesi!

Ato ce thua ti perparimé
S'jane ghe per tyne véch sé gabim,
Dhé per boten jane pshéretimé
Sado ce dukét nde cytéterim!

O ze, o mfshénjé ce s' deftéhésh
Trego-me shkakun, be-me te kuptoñ
Ch' pune eshte? ne esht ce s' refréhésh
Meso-me te paken si te shpetoñ...

O ch' pun' é frikshmé per jéten t'imé!
Thuaj-me t'lutém sa me perpara
Ku 'sht lumtesia ku s' ka vajtimé
É ch' shkak i sjéll botes ac te ndara?

Per ñe hére m'u-duk ñe chkrépetim
Dhéu tundéj, kembet mê s'me mbanin,
Dhé duk' zbritur tatepjéte mé ndzitim
Keto fjale deghova éren c' é chanin:

„Ñe pun' é prish ñérine édh' é chpon
Te vritét, t'vrase, é pa turp te vjédhe,
Te lér' atdhé, prinder, dhé ghe ce s' shekon:
Sé dô véch ar nde taske t'i riédhe!"

MENTIMÉ

Shume hére ri é cañ
Vogeline kur kujtoñ,
É ghith sa ment i mbañ
Nga fund' i zemres lotoñ!
Lotoñ... sé mê nuk mundét
Prape mé sy t' i shekoñ,
Sé jéta ghithe shkundét
Dhé me kot un' i kerkoñ.
Zemra ghithe me renkon
Édh' eshte plot hidherimé
Si kurdohére ce lengon
Kur deghon pshéretimé.
„Zemer kurre mos caj
Sé bota per kto esht bere,
Ch' do gezim é ch' do vaj
Né do t' i hécim te tere".
Éjani o dit mé bukuri
Jû ci per hér' me geznat,
Kthéjuni ketu perseri
Sé ce kur ikte m' hélmuat!

BUSH

Éjani jû lulé t' prendvéres
Ci gezoni boten é ghére,
Dhé ju bilbile t' véres
Mos m' lini nde shketére !
Ah ! per jû eshte dita sot
Boten ce te gezoni,
Sé une me s' munt dot
Véch t' ju thém... kendoni !

BKSH

PÉRENDIA

O Zot i math i vertéte
Dhé beres i ghithesise,
Ce jép drite ce jép jéte
Natyres dhé ñérezise.
Ti é ké tere fucine
Sé ti boten é urdheron,
Sa levizin dhé sa rine
Ti i kembén dhé ti i ndron!
Ti ben détét te valojne
Érrat te fryjne mé ndzitim,
Édhé réhte te ghemojne
Boten t'a tundin pa pushim.
Ti ber-é djéll édhé héne
Yjte édhé hapesire
Ce te ghitha i ké vene
Mé mjéshteri dhé mé hire.
Ja ñériu sa i chcuar!
Ghithe ch' ké bere si i shéh,
Tyne duké te levduar
Per Zot te vertéte te ñéh.

PUSH

Ti beré kafshet sa jane
Ay ce t'i kéte ndihme,
Ace punera pa ane
Dhé per ushcim i-dhé bime,
Kudo kthéhésh, kudo shekon
Fucìa jeté provohét,
Ce as ñéri nuk'é mohon
Sé esht ghe ce vertétohét.
Ti sjéll dimer dhé vére
Shi debore édhé vése,
Vjéshte si édhé prendvére
É ch'do ghejé i jép ndjése.
Pra ti jé Zot i vertéte
Ci an'é mb'ane mbréteron
Ty te ñohim Zot per jéte
Sé ti ghykon, ti urdheron!

BKSH

PUNA

Kujt s' i pelcén te punoñe
Ay s' munt te cuhét ñéri,
Sé kerkon ghithe te roñe
Mé geñéshtra é djallezi.

Puna é ndéron ñérine ;
Ajo i sjéll fatbardhesi,
É ka plot édhé shtepine
Kurre s'mbétét mé dor' me ghi.

Pra punoni sa te mundni
Mos rini ghithe nde pertim,
Dhé varferine t'a shkundni
Pastaj te roni nde cétim.

Pertimi sjéll te kécia
Dhé nde semundjé te shtié ;
Si t'a doje Pérendia
Kur ñériut s'i ka hié!

PASH

Shume jan'ata ce rine...
Dhé femija vdés urijé,
Po te veshtrojne shtepine
Mbaresia lark i shpié.

Natyra ka mjaft deftimé
Ce na meson si te bejme;
Ci per né jane burimé
Mé mendjén si t 'i chbejme.

Shpéset, kafshet nat'é dite
Ghithe perpicén per ushcim,
Edh' i kane plot shtepite
Sépsé punojne mé mundim.

Ashtu dhé né te punojme
Si duhét mire per ushcim,
Bégati te mos lakmojme
Sé édh' ajo sjéll hidherim!

BKSH

Cétesia é zémres

I

Atjé mi bar te prére
ku éra nuk' pushon
Ku flytyra nga hére
mé mall vété cendron,
Ku léndin' é pa sosur
zghatét gher' é ghate
Édh' ér' é ballsamosur
fryn dit' édhé nate.
Ah! atjé nde cétesi
dua t' jém mê mire;
Sé atjé esht lumtesi
ku munt te ghéñ hire!

II

Atjé ne més t' atij pyllit
ku bari ghélberon
Ku drit' é embel é yllit
mé shijé dzhidzhillon,

BUSH

Ku perroji ushetin
mé ze te pelcyér
Dhé uja si erghent ndrin
duk' u-rekellyér,
Ah! atjé zémra me do
nde préhjé te jéte,
Sé véch atjé munt ajo
cétesi te kéte!

III

Per atjé nde natyre
kur ajo po chfacét,
Enda shum' me ka hyre
zémra me kenacét.
Sé harroñ ch' do meñtimé
sa ka kejo bote
Brénga dhé hidherimé
c' askush s' munt t'i thote.
Perandaj kurre s' é lé
per ch' do ghe nde jéte;
Sé atê sa hér' é shéh
zémra t' esht' é céte!

BUSH

I BURGOSURI

Ilidhur kemb' é duar
Shkon udhes mé uñesi;
Jéten duké mallkuar
i mjéri ñéri.

Varghét ce i héc dzvare
Me dysh é kane thyér,
Syt' i ka me te care
poshte mberthyér.

Mé shpirtin te hélmuar
Ri dhé meñtohét thélle;
T' emen duké kujtuar
ce é ka pjélle!

É ñéh te ligen c' é prét
Pas kallezimin ce ka;
Oh! meñtimi liksh é trét
nde zémer é hâ!

BKSH

Dinté sé s' kish 'noñe faj;
Po kur é drejta mſhihét
Tjater é peson pastaj
ce mê t' mos ngrihét!
. . . . . .

Dhé kur u-ghént fajtori
Nde burg ay kish vdékur
Me cafe si é mori
ñe zémer hékur!

BKSH

DHÉU I HUAJ

Prendvére é bukur ishté chélur
Édhé bilbilet mé mall kendonin,
As bâri ghekundi s' ishté shkélur
Po te ghitha bukur lulezonin.
Véch nde ñe shtepi mb' ane te fshatit
Shtepi é vogel pa 'noñe shenim,
Renkonté ñe plake me brii te shtratit
É mbétur é mjéra nde fillerim.
Perjashta shélgu prane shtepise
Édh' ay rinté uñur mé trishtim,
Sé ndjénté zién é varferise
Ci atjé mbréteronté pa pushim.

Oh! dit' é shkréte, mos u-gdhifsh kurre
Ti ce ndavé mé lot mem' é djale!
Ti nuke trét shkembiñ édhé gure
Po trét zémrat vétem mé ñe fjale:
„Udh' é mbare, vafsh é arthsh mé shendét!"
I thote djalit mema é mjére.
Édh atjé me vent é varfera mbét
S' i ndahéj; sé mallin s' muntté t' a ndzjére.

Bir o djale méjé ce largohésh
Kujtc-me nga hér' é mos me harrô,
Kudo cofsh per mua te meñtohésh
Plécerine, biro, mos m' a hélmô !

Keshtu i thoshte djalit é ghora
Dhé i lutéj te mos é harroñe,
É me s' é linté faré nga dora
Po é mbanté êdhé t' a shekoñe.
„Mos ki kéc, nené, ay i thote,
Ty une nuke te harroñ kurre
Kudo ne cofsha nde kete bote
Ghitheñe do te sillém si burre !
Kam mall per kete vent ku jam ritur
Per kete shtepi ce me dha drite,
Ce t' i harroñ eshte pun' é merzitur
Zoti mos é dhente kete dite !"

Vjétét shkuan édhé me s' u sosne
Djali t' emen ghith' é kish kujtuar...
Po kur t' tjéra zemren j' a plagosne
Lutjét é s' emes i kish harruar !
Priti é mjéra, oh ! priti shume
Édhé canté ce tundéj shtepia
S' kishté cétesi, s' kishté as ghume
Per djalen c' é kish si Pérendia.
Ah ! or bir, psé keshtu me harrové
Psé nuk' é mbajté fjalen ce me thé :
„Nené mos caj sé s' t' harroñ" dhé shkové
É tashi me s' dukésh, o bir, ku jé ?

Me kot é prét o moj plak' é ghore !
Yt bir te harroj é me s' te kujton,

Sé ka tjatær *ghê* c' é do si *korre*
Dhé per 'tê nat' é dit' ay renkon !
Ty ashtu te durosh t' eshte dhene
Te mos késh dit' te bardha nde jéte,
É thiñur, é permbys kryét vene
Te vuash ghér sa te shuhésh véte !
Oh ! s' ka pune m' é kéc' é m' é ndyre
Kur harroj memen c' é kish lére,
Per ate ce ay kish detyre
Nde hélmim kurre te mos é shtjére !

Ciélli ish stérre, malét ghemonin
Vériu frynté, dhé flétet binin,
Korbet toghé toghé udhetonin
Dhé ñe ze te trishtueshm kudo shtinin !
...,Se largu ñe hijé po afrohét
É nde fshat hyn ghith duké kerkuar
Shélgun é shéh, i uret leshohét
Te shohe ate c' é kish harruar !
Cé ay ! ardhi te shohe t'emen
Sé é kujtoj édh' ay nde jéte...
Po ch' te shohe kur i vuri ghemen
Sé shtepine é ghéti te shkréte ! !

LUMTESIA

Shume thone sé vjérshat duhét te jéne
Te shkruara ashtu, ce te jésh nde gezim
Te mos é hélmojne zemren, te mos kéne
Chasé hidherimi ce te biésh nde trishtim!
T'a reféjne boten sé ghith hére chkelcén
Sé s' ka brénga dhé lumtesia mbréteron!
Ah! ch' lumtesi, kete sitsilido é ndjén
É kush esht nde bote ce kete s' é kerkon?
Kur ay ce é kerkon ac lumtesine
Dhé s' munt t'arije ñe cellim ce deshiron
Mallekon Pérendi édhé ñérezine
Sé s' i ndihn fati per ate c'ay lakmon!
Po kur ñériu eshte nde kenacesi
É s' ndjén névojat é botes ce é rréthon,
Oh! at'hére ch' i duhén dhé vjérsha mé bukuri
Kur ay é ka nde tasket ate ce é gezon!

PRSH

PERFYTYRIMÉ

Yjte mi ciéll po ndritin
Dhé hena mé nga dal' pérendon,
Te ghitha bukur shetitin
Si dita pas dites ce shkon.
Ti ñéri i mjére ce po ron
Véch ty zémra s' t' esht ne pacé,
Ch' do ghe syri ce te shekon
Ajo tundét, dridhét sa kacé.

Por si réhte nde cétesi
Kur ñe djéll' i bukur chkelcén,
Éra i shtyn mé vrapesi
Perpara drites se tij i mberthén.
Ashtu dhé ñériu shum' hére
Kur i dukét sé esht i céte
Dhé cétesin' é ka ndjére
Turbullohét, ghê pa t'kéte!

Per ch' do shkak ay ce thote
Béson sé boten é fitoj,
Po kur i dél puna é kotte
Ay fytyren sa kac' é ndroj.

PROOF

Esht si déti ce nuk' levis
Kur koh' é bukure shendrit,
Po kur furtuna prap'u-nis
Ahér' ay zemrimin é cit!

Hére kur ri duk'u-meñtuar
Mé facén t' pacte pa trishtim,
Po per hér' ghê duké kujtuar
Ghaku i eshte nde trazim.
Nghét si ciélli c'esht i kulluar
Po ñerjésh mvréjtét é ghemon,
Dhé shiu me te pikuar
Ndron facén é dhéut ku shkon!

Ashtu eshte ch'do ghe nde bote;
Te ghitha sa jane ndrojne,
Kembéhén, kthéhén si rote
Sé ndryshe s' mundin te rojne.
Si natyra dhé ñériu
Ndryshohén pà 'noñe pushim,
Si dbora édhé shiu
Ce me s'kane kurre mbarim!

BKSH

Vertétesia é gherravét

(La réalité des choses)

Mu si fléte préj ér' é shkundur
Ce bié duk' u-rekellyér,
É fillt' é ghora é mundur
Trétét é vénitur é thyér,
Ashtu édhé une nde bote
I filleruar ghithe rréthoñ
Duké pritur; shprés' é kotte!
Te shoh me sy ghithe ch' enderoñ!
Nde kete océan pa mase
Ku valat ngrihén mé ac' terbim
Ték ñériu munt te humbase
Kudo mé te kerkuar shpetim,
Sa endra, sa shprése nuk thyén
S' perpicén si me shkemb te forte;
Si valat ce trazohén é mfryhén
Dhé prap' kthéhén ghith' nd' ate shorte!
Ah! sa endra t' embla s' veshtroña
Dhé sa shprése nuk m' embelsonin,
Pritme âri ghithe bésoña
Ac' é ace gherra me gezonin.

Ñe bot' é pañohur me tfacéj
Ñe udh' é ghere plot mé lumtesi
Per sé do zemra me kenacéj
Si nde pellasé mé bégati!

O endra te bukura ku jini
Ju ce é ushcéni ñérine,
Dhé ghér mbe ciéll ce é ngrihni;
Ah! ce perndani lumtesine.
Ac' te shkurter' é kini jéten
Ce tréti ashtu shpéjt si akull,
Ngrihi si avull nde te ndzéhten
Édhé shuhi si ñe merakull?
Jini si lulét ne prendvére
Boten rréth ce é zbukurojne,
Shpirtin c' é kenacin nga hére
Bukuri ndajne, lulezojne.
Po kur mé rébtesi fryn éra
Édh' i perhap andéj ketéj
Shuhén, thahén ner ghemb' é férra:
Ashtu dhé jû kurre me s' u ghéj!
Flytyroni dhé percéshni
Ñeriut s'i lini véch trishtim,
Dhé nde hidherimé é nghéshni
Ce te mundohét pa perdellim!
Me kot perpicét mé ghith' fuci
É s' lé ghekafshe pa kerkuar
T' i mbushén enderat si é si
Vétén t'a ndjéje te gezuar.
Sé hére kur i arrin, béson
Sé do t' i mbétén tere jéten,
Po kur ñ' é lig' i nghet, i harron:
Sé, perpicét mé *te vertéten!*

Féja é vertéte

Tré véta po hahéshin ñe dite
per ñe pune ce s' é dinin véte ;
Sé kerkonin te ndzjérin nde drite
tsila eshte féja é vertéte.
É si ghithekush levdonté te tijne
sikur kush é di ch' do te fitonté,
Kur shpésh shohim sé nga féja vijne
gherra, ce ay s' i kupetonté !
Keshtu, ñe tjéter atâ i deghon
é ce t'u jape te kupetojne
T'u thote tsa fjale i keshillon
po véch mé veréjtjé t'a deghojne.
T'u-reféje édh' ay ñe mesim
nga te mentshem c'é kish deghuar,
Kush te doje lé t' i jape mbésim
sé ghe ghithe ka per te mesuar.
Ata mé deshire i afrohén
te shohin ch' do te ndzjére ky shéshit ;
Sé shume jan' ata ce levdohén
sé ch' do fjale i pelcéñe véshit.

BUSH

Éjani, u-thot', é me deghoni
mblidhuni ce te tré prane ketu,
Pastaj ce te mundni te ghykoni,
édhé fjalen miku é nis keshtu:

* * *

Ish ñe mbrét i deghuar ñe hére
ci mé fucin' é tij urdheronté,
Ñe mbréteri te madh' é mé vlére
ac' sa tere bota é tsmironté.
Cé i lumtur édhé shum' i kenacur
nde ate fron ace te chkelcyér,
Sé per 'te trimerira kish tfacur
dhé ghak kishté dérdhur pa kurtsyér.
Ndênesit ce te ghith' é ndéronin
Kurdohér' ay jashte ce dilté,
É ch' do ghe ata ce i kerkonin
mé gazmend dyért i a u-chilté.
Po ch' do lumtesi nde kete bote
si ch' ka fillése ka édhé mbarim,
Perandaj kurre 'none s' munt te thote
sé pas gezimit s' vjén édhé trishtim.
Sé édhé véra na sjéll bukuri
é na é mbush zemren mé gezimé,
Po kur dimri na kujton perseri
s'é présim véch sé mé hidherimé.
S' ka fjale; bot' ashtu eshte bere
sot te gezon é néser te hélmon,
Eshte kanun' i natyres se tere
ce ch' do ñéri kete é kupeton.
Pra édh' ata ci mbrétin é mbanin
mé ac' te madhé krvélartesi,
Érdh koha ce duhéj ce t'a ndanin
si ch' eshte dhene, ndryshé s'kish sé si.

Ashtu dhé mbréti tashi si u-mplak
kish édh' ay ghe per te chperlare,
Sé ñériu me c'eshte mish é ghak
kesaj boté i esht per te ndare.
Édhé sa cé i fort' é mé fuci
ce fciñet s' kudzojin t'i afrohén,
Bié i semure si plak ñéri
dhé ndjénté sé ditet i mbarohén.
Kur or' é fundit i u-afrua
dhé frymen Zotit do t' j'a jipté,
Atij ce shprésa kurre s' i u-shua
tashi kete ay po é lipté!
Te jét' i ghall' édhé tsa dite
ce te ndréctoñe ghen' é shtepine,
T'i keshilloñe te tré te bijte
kujt t'i lére fron' é mbréterine.
Sé, ce te tré fron' é deshironin
dhé sitsili perpicéj pa pushim
T'a bintté, sé fort mire shekonin
sé jét' é tija esht ne pérendim.
É sitsili plakne é ndéronté
mé fjale te embla kur i flisté,
Édhé duart ghithe i ferkonté:
vall' ate per mbrét do t'a theristé.

Plaku cellimét j'a u-kish ndjére;
édh' as ñe ce te mos zemerohét,
U-meñtua thélle shume hére
kesaj barré ce te léhtesohét.
Tsilin munt me vent te tij te lére
é si t'i pacésoñe te tjéret,
É cysh nga kjo ngatrése t'i ndzjére
per 'te kjo cé ñe pun' si é érret.

Po kur duk' u-meñtuar po rinté
ñe mendim i bukur me chast i vjén,
Sa cé i semur' é s' pipetinté
nga shtrés' é tij per ñe hére ketsén.
Ah! ch' mendim i bukur, tha, cenka
é sa mire kur ñériu ghykon
Punerat me pare, é s'u lenka
ce pastaj te mos jéte téper von.
Édhé urdheron sherbetorit ce kish
te therése me shpéjt ñe erghentar,
É si ñéri bésnik ay ce ish
vajti; sé per mbrétin hynt' é ne zjar.
Sherbetori vjén prape mé ndzitim
é té mbréti hyn mé shum' uñesi,
Dhé: é solla, thote, o Zoti im
é ghith' ashtu dél jashte perseri.
Erghentari brenda po sa ce hyn
mbrétin mé te falura é ndéron,
É pastaj déren mire si é shtyn;
mbréti prane te viñ' i urdheron.
Deghova sé punon mé mjéshteri
i thote, é ch' do pun' é ben mé ment
Andaj te thira te vish ketu ti
sé kam per te vene ñe ghe me vent.
Pra, sheko kete unazen t'imé
é thuaj-me ne te mundét te besh
Ghithe si kjo po pa ndryshimé
édhé dy te tjéra, 'ré shume te vesh
Ce te mos ñihén nga é vertéta
po te jéne ghith' ñe si te thashe
Si é para, é dyt' édh' é tréta
sa holle te jén' ac' édhé trashe.
Édhé mire faré po t'i mbarosh
mé te téper do te t'i paguañ,

Po sheko sa munt me shpéjt mos harrosh
sé ne mos jéten une t'a shuañ.
Erghendari, thote, kupetova
fort mire é Chkelcyshmé Zoteni,
É te ghitha ch' me thé i deghova
fjalet é tua édhé porosi.
É me ate menyre si ch' hyri
dél jashte, po mé te madhé habi
Per ter' ato ce i a pa syri
te tsilat per 'te ishin ñe chudi!

Per tsa dit' erghendari i solli
édhé mbrétit j' a bié nde duar;
Te tri ñe! sikur ñe mem' i polli
i thote mbréti shum' i gezuar!
Mér te hollat édh' étse mé shendét,
ay mé kenacesi é pertsjéll,
Po erghendari jasht' s' di sé si shkét
bié i vdékur é ghak gojes vjéll!
Mbréti i shéh, i mat, édh' i kerkon
ne nghasin mire mé te *vertéten*,
Per te tsilen shume hére renkon
sé ajo i kujton tere jéten.
Sé ajo eshte sheñ' é mbréterise
dhé pa ate 'noñe mbrét s' munt t' jéte,
Eshte kurora é trimerise
ce é kish nga sterghyshrit é véte.
Pra kete kujt t' j' a linté meñtohéj
sé sitsili ñe deshire kishté:
Te behét mbrét; é ghithe levdohéj
sé per vendin pallen do te nghishté
Do te luftonté do te dermonté
ch' do armik po t' i dilté perpara,

Perandaj mbréti nuke kudzonté
t' i lére punerat te perchara!
Dhé te parin véchan si é therét
i lotuéshm i flét mé mall âti:
Bir, ti m' i math jé, é ty te perkét
te jésh mbrét, ashtu é do dhé fati.
Ti me ké ndéruar kurdohére
kurre nde jéte s' me turperové
Sillésh mé ment, punové pa prére
per mbréterine, é me gezové.
Pra, mbâ unazen é mbréterise
sé ty t' a lé mé ghithe deshire,
Te jésh mbrét édhé zot i shtepise
po véch t' jésh trim édhé zemer-nire.
É po t' a thém édhé kete pune
ne me do, é ne jé djal' i mbare,
Mos é refésh ghér sa te vdés une
sé ndryshe thone, sé jé i marre!
I biri nde taske si é vuri
mbrétit i puthi doren é balle,
É per café mé mall si é zuri
dél jashte mé ñe gas si te ralle!
Pastaj te dytin te viñ' é kerkon
é prân' ay si i u afrua:
Bir, i tha, ti ghitheñe me deghon
perandaj édhé une te dua.
É per ch' do fjale ce te kam thene
ti kurre s' me ké cene ne kundershtim,
Po te ghitha me vent i ké vene
é s' me ké sjélle ndoñe turbullim.
Perandaj mé te madhé dashuri
une te zghodha te me zesh vendin,
Sé ti jé trim é burre, si ch' te di
é nuke do t' m' a turperosh kendin.

Mér-é unazen édhé mé kujdés
t' a ruash, é nga te tjéret t' a mfshésh,
É pastaj une po sa ce te vdés
atyré munt ce t' i a u refésh.
Ghér ahéré sheko mos bej fjale
sé po te t' pikase 'noñe ng' ata,
Pastaj si é cysh ké per te dale
as une s' di sé si, t' a thém pa prâ.
Djali é mér é ghith si i pari
é percafon t' atne mé ndzéhtesi,
É kur dél; chuditéj si j' a mvari
t' étt, geñéshtren mé ac' léhtesi.
Mbréti me s' vonon é kohe me s' humbét
sé ditet i shkonin mé vrapesi,
Édhé te trétin te viñ' é therét
ce t' i lére édh' atij porosi
Éja, o bir im i dashur ketu
i thote plaku mé loté ne sy,
Te te puth ballen é facét é tû
sé ti jé zémra imé dhé vdés per ty.
Sa shume te dua s' munt te t' a thém
kur te shoh tyne shpirti me nghallét,
É sa dit' akoma ce do te kém
te vish prane zémra te me chmallét.
Perandaj ce shum' é kisha nder ment;
é nuk' t' a thashe, po t' a thém tashi,
Sé ti do te jésh zot mi kete vent
ce, te ghithe te te kéne zili.
Mba-é unazen é fut-é nde ghi
mos é defté vellézervét é tû,
Bej-u sikur ghekafshe nuke di;
ndryshé thone sé s' ké nde koke trû.
Dhé, pas vdékjés' s' imé munt te thuash
sé ti ké te dréjten te behésh mbrét,

Mé ghithe ce tsa pak do te vuash
sé nuk' do t' bésojne mé te vertét.
Ay si pershendosh t' atne iken
i kenacur shum' édh' i gezuar,
Sé te dyvé j' a u-vuri thiken
édh' i geñéu pa shprésuar!

Tani sitsili ng' ata po pristé,
— sé mbréti êdhé shume me s' ronté
Per tsa dite ay do te vdisté, —
permi te tjéret ce te mbréteronté.
É mé te vertét sé s' vonoj shume
édh' or' é vdékjés mé vrap afroj,
Sé mbréti râ per jéte nde ghume
si i pa ce te ghith' édh' i békoj.
Si é mbuluan édh' é cane
ata si édhé ghindja é tere,
Pastaj u-mblothne te tré me ñ' ane
te keshillohén ch' esht per te bere.
Kush t' jét' i pare, kush te behét mbrét;
sitsili ndjéhéj i lumtur véte,
Sé kish unazen thésar te vertét'
édh' é mbanté hunden perpjéte.
Po m' i madhi shume me s' i duroj
é nga taska ndzjér unazen c' é kish;
Te shohe sitsili punen i ftoj
sé ay esht mbrét, ndryshé pune s' ish.
I dyti, tha, unazen un' é kam
mua plaku mé dor' véte m' a dha,
Pra une tashi me vent te tij mbrét jam
é as ñe nga jush te dréjte nuk' ka.
I tréti: vellézer te me ndjéni
u-thote atyré mé mallenghim,

Me kot ace fjale po kembéni
sé jû ce te dy jini nde gabim.
Édhé unazen é deftén mé vrap
é kerkon t' i bindñe mé ch' do fjale,
Po me kot ay goj' é syt' i hap
é hidhéj perpjéte si ñe kale.
Sé unazat ghith' ñe mase ishin
si dô ce t' i kthéñé a t' i viñé,
Ñe fytyre ce te trija kishin
me ne funt, ñeren tjétres s' i ñihñe.
Ata mé habi po i shekonin
é chuditéshin per kete pune ;
Sé u-geñyén tashi bésonin
é ne mendim ce te tré u-vune.
Tsilin te pyésin, si te bejne
é cysh nga kjo ngatrése te dalin,
Ku mundin te véne t'i reféjne
fron'é mbréterine kujt t'j'a falin.
Urdhérojne te mentshmit te mblidhén ;
munt ce te ñohin kush é di sé si,
Po ata ce te ghith mé ñe zê hidhén :
vétem mbréti ce vdic ay é di !
U-thane te pyésin erghendarin
ci mé mjéshteri i kish punuar,
Po kur tragen vane t'i a marin
u-thane sé nde dhét esht mbuluar !
É sitsilindo ata c'keshillonin ;
ne ñéh ch'unaze esht é vertéte,
Kudo ghithe ñe perghighjé deghonin :
s'é ñohim, i vdékuri di véte !

*
* *

Ja or shoke, u-thot' ay miku
ne doni te dini te vertéten,

Dhé ghér sa nuk'é chkociti s'iku
ce t'a kéne nder ment tere jéten,
J'u pyés tashi mire ne dini:
tsila eshte féja é vertéte?
Te me thoni dituri ne kini
per kete pune ace te léhte;
Ata u-meñtuan, u-perpocne
ce t'i perghighén mir' é si ch'duhét,
Te ghitha féte mé fjal' i ndocne
as ñe s'di, é te thote ghê ruhét.
Por ay, u-thote, s' kupetuat
ch'u-be mé unazen é vertéte?
Kudo ce pyétne, si ch' mesuat
u-thane, i ndjyéri di véte!
Ashtu dhé féte nde kete bote
tsila munt te jet' é vertéte?
Prâ, mbani-é ment mire u thote:
kete é di Pérendia véte!!

BKSH

DASHURIÉ

BKSH

BKSH

DASHURIA

Bota sikur te permbysét
A djélli te perveloje,
A po dita ce te ngrysét
Dhé nate ce mbréteroje,
Tere keto nuke mundin
As pak ñérine t'a mbajne
Dashurine t'i a tundin
Édhé sojé ce t'a ndajne.
Kurdohére dashuria
Ka cen'é fort' édh' é vjyér,
É ka lene Pérendia
Ñérine per te ushcyér.
Ciélli ce kur u-kriua
Mé ghithesine c'é rréthon;
Dhéu ce kur u-fillua:
Dhé dashuria mbréteron.
Si nde kesoll' é nde pellas
Kudo c'eshte dashuria

BKSH

Ghithe te mirat jane pas
Eshte véte Pérendia!
Kjo po te mos kishté cene
S' pacésonéj ñérezia,
Do te ish si é pa ngrene
Do t' trétéj nde te kecia.
Kjo é larteson ñérine
I-ép zémer, i-ép fuci,
I-sjéll édhé lumtesine
Dhé ron ghithe nde harmoni.
Perandaj as ghe s' me ndalon
Dhé mua nga dashuria,
Sé ajo zémren m'a ngron:
Eshte véte lumtesia!

BKSH

Ñe ore lumtesié

Hena ndritté por si erghent
Kur nde kopshte bashke vinim,
Dhé mé doren mi krahun t'ent
Te ndihña mi bar te rinim.

Ah! sa embelsire ndjéva
Kur doren t'endé m'a zghaté,
At' hér' faré me s'é mshéva
Mire-dashjén zemres s'até.

Lulét na chonin ñe ére
Shum' t' embel é te pelcyér,
Edhé zéfiret nga hére
Na kujtonin pa kurtsyér.

Rézét ce na pergezonin
Kur ishim te percafuar,
Dushurine na é shtonin
Mé ñe mall te pa harruar.

BKSH

Sa fjale t' embla me thoshé
Kur perkedhéléshim te dy,
Dhé mé sychkat bukuroshé
Me beñé te mos ndahém nga ty!

Po dyshimi nuk me linté
Te te bésoñ sé ti me do;
Si hena rézét c' i mſhinté
Dhé i chonté ku désh ajo!

Véch ahéré kupetova
Sé jé zémer plot meshire,
Dhé vétén t'imé é ngrova:
Kur me puthé mé deshire!

BKSH

MALLI I LÉNKES

Shih-é atjé mu nde déra
Lénka é malleshmé si prét,
Dhé meñtohét mé duart pshtét
S' é tremp as shiu as éra.
Véch te dashurin dô t'a shohe
Sé ce kur s' u-duk ka kohe.

Syt' é saj jane flag' é zjar,
I-dridhét zémra kur é shéh,
Sé mallin ce ka dot s' é mfshéh
Per ate djale kordhetar.
Sé syr'i tij si shighéte
I-beri plage per jéte.

Ay trim édhé djal' i ri;
Pran' asaj sa hére shkon,
Dréth mustacét édh' é veshtron
Mé mall zemré dhé dashuri.
Ah! sa gezohét édhé césh
Kur é shéh te meñtuar shpésh.

BKSH

Oh! é mjéra po sa renkon
É sa hére s' bié ne trishtim,
Édhé s' eshte nde meñtim
Kur ay shkon é s' é shekon!
Po ch' ka te beje kur i tha:
„Sé m' é bukure sé ty s' ka!"

Véch mbremanét me te ngrysur
Kur bagetine vété mbléth
É mé *'tê* picét neper ghéth,
Duké lojtur é permbysur
Ay s' é lé nde cétesi
Po ghith' é ngét mé djallezi!

Ah! sa lumtesi ajo ndjén
Kur ay mézin i shtrengon
É mé mall é percafon
Dhé mé te puthura é ndzéhn,
At' héré mé s' eshte mbi dhéé
Po shetit mbi ciéll é réé!!

BIBLIOTEKA

DINAKERI

moj Thine psé nuke vjén
Atjé tutjé nde perrua
Sé atjé mua me pelcén
Te los mé facét é tua.

Ketu eshte udh' é madhé
É na shohin ñérezia,
Po haj vémi ne luadhé
Ku s' na shéh as Pérendia!

Haj me shpéjt é mos bej sé s' do
Sé t' i di zakonét une;
Kur atij i thé: pa sheko
Noñe mos na prishñe pune!

BASH

Malli i péshketarés

éshketar, péshketar mos ndzito
Mbaj-é lundren é me vent cendro
Sé me k' enda te t' shoh!

Péshketar ci ujen é trazon
Dhé mé krahte valat i mergon
Kthé-u é mé sheko!

Péshketar ci déti s' te tméron
Kur ay mfryhét, ti ze kendon
Kthé-u mos me harro!

Péshketar ci ké djellin per sh›k
Henen si édhé ghith yjte tok,
Prit, prit mos u-largo!

BKSH

PRANE TÉJÉ

Oh! mé sa zjar ce te dua
Ac' sa nuke munt te t'a thém,
Per ty me réh zemra mua
Dhé prane téjé dua ghithe t' jém.
Ñe lulé sikur te jéshé
Do te te mirña prane méjé,
Édhé ti te mos me déshé
S' chnghitésha kurre préj téjé.
Dhé shiu sikur te bjére
A po éra t' vershelléje
Nde merzi s' munt te me shtjére
Édh' as ghe s' munt te me kthéje.
Dashuria per ty ce kam
Nuk' me lé ce te largohém,
Prane téjé keshtu ku jam
Dua te vdés te cétohém.

Fucia é dashurise

Kur éra fryn mé embelsi
dhé facén m' a perkedhél,
Ah! ahéré ndjéñ ñe fuci
ci zémren sikur m' a chél.

Kur djélli ndrit mé ngrohtesi
édhé trupin m' a gezon,
Mendja me iken mé vrapsi
édhé endera veshtron.

Kur hêneza mé mfshéhtesi
mi mua rézét i chon,
Shtrihém sé jam nde cétesi
Po ghumi nuk' me pushton!

Kur réhte jane nde ghemim
dhé koha rende mvréjton,
Ghaku im eshte nde trazim
dhé shpirtin m' a turbullon.

BKSH

Kur déti zjén mé duhii
édhé valat i shekoñ,
Ahér' meñtohém si é si
atjé te hidhém t' shpetoñ!

Po kur krahete m' i zghat ti
édh' une te percafoñ,
Oh! mbaj-u zémer sé tashi
dua êdhé ce te roñ!!

BKSH

BEJ ÑE TE MIRE

Syri yt, chupe
Shume me pelcén,
Goja si kupe
me defrén.

Gushen é bardhe
Fal-m'a ñe hére,
Facét si dardhe
m'i bjére.

Si rézé djélli
Shum'é pelcyér,
Ce zbrét nga ciélli
é vjyér;

A por si ñe yll
Ce po dzhidzhillon,
Ci mal, fush' é pyll
zbukuron

BKSH

Zémren c' é kenac
Shpirtin c'é nalton
Deshiren é tfac
te gezon,

Ashtu édhé ti
Dua si keto,
Zémren si ti di
m'a gezo.

Dhé mos me lére
Keshtu te vuañ,
Jéten é mjére
t'a shuañ.

Po ki meshire
Si enghell ce jé,
Bej ñe te mire
mi ket dhé!

BKSH

ÑE ZAKON

Tsilé, ch' ké mé mua ce s' me flét ?
I-thote Markua sa hér' é ghén
Nde krua kur uje vét' é mér,
Bésa, s'me thua mé te vertét
Psé ashtu koken ghith' é kthén
Facén é mfshéh, sikur do t' t'a chjér?

Nuk' shéh Marko sé ch' flasin bota ?
Si duron te ketilla fjale
S'eshte turp ce te céshin mé né ?
Ti munt t'i maresh per te kota,
Po un' jam chup' é s' kam dale
Ghér sot as ghekundi, ti s' ve 'ré ?

Oh ! Tsilé s' me lé dashuria
Dua te te shoh kurdohére ;
Ti jé enghell' i jétes imé
Te ka derguar Pérendia
Si manushacé nde vére ;
Po mos m'a bej zemren thrimé.

PROOF

Te riñte tere keto flisnin ;
Zémrat te dy i kishin lidhur,
Mé bé sa te rojne nde jéte
Dashurine te mos humbisnin.
Per 'ta jéta s' ish édh' é hidhur
Sé s' kishin nde més ghe t'méte.

Fshat' i tere kish deghuar
Sé kur nde krua te dy picén
Flasin, céshin dhé percafohén,
Kuvendojne per t'u-martuar
Tere diten c'atjé nuk' hicén
Po duk' u-puthur ghith' harrohén.

Po zakon' i lik me s' u-shua
Ci nd' ate fshat mbréteronté.
Sé é ema te bijen s' déshté
A po kurre nuk' u-meñtua
Ku désh chupa t'a martonté ;
Dhé per dit ghith' é perléshté.

Po dashuria s' ndalohét
Kur nde zémr' ajo ka mbire
Dhé reñe ka zene thélle ;
Sa t'a ndalosh ghith fortsohét
Eshte rende per te fshire
Sé nga Zoti eshte pjélle.

Pra, dhé Markua mé Tsilén
Si ñe trup ishin bashkuar
Po thuaj si motr' é vella ;
Por si dy lulé ce chilén
Edhé ritén pa pushuar :
Ashtu ishin édhé keta.

Po me kot ace dashuri
Kur cellimin s' é arrinin
Ce te behén te dy shoke,
Édh' é prisnin pa cétesi
Diten é madhé te shihnin
Kuroret vene me koke.

Markua mjaft kohe priti
Mé Tsilén ce te bashkohét
Duk' é-kerkuar pa pushim,
Po pastaj shprésen é ngriti
Si pa puna sé s' mbarohét ;
Dhé ghéti tjater pa dyshim.

Dhé Tsiléja mbét duké pritur,
É ema burre t'i ghéñe
Si ch' asaj do t' i pelcénté,
Ghér sa u-be é merzitur
Dhé bota zu t'a reféñe
Mé ghisht, kur é shembellénté !

Ne, prindrit é saj me pare
Nuke déshnin t'a martonin
Atjé ku désh chupa véte ;
Pastaj kur mbéti mé barre
Édhé turpin é shekonin ;
É mbajtne nde shtepi per jéte !

HARRIMI

Ghéthi kudo kish mbléruar
Dhé fusha ish nde lulezim,
Kur bashke mé goj'é duar
Puthéshim, lonim mé pelcim.

Ah ! é mbañ ment ate dite
Ndene ghéth kur rinim te dy,
Dhé te mfshéhur nga ch' do drite
S' ngiñéshim se pari mé sy.

E di mire kur beñé bé
Sé me deshmon te vertéten,
É mé zémren plot kur me thé:
Do t' te dua tere jéten!

Ce at' héré ce kur u-ndame
Sa dite ce kane shkuar,
Ce kur prape me s' u-pame
Une nuk' te kam harruar!

PASH

Nuk' di ti valle n' é kujton
Ate ore te pelcyér ;
A po koha munt ce fajton
Dhé t' a ka zémren kthyér !

Dyshoñ mos dal' é vertéte
Fjala é motshmé ce thote :
Syte ce nuk shihén léhte
Harrohén nde kete bote !

BKSH

S' ké ti faj!

Un' é di kete fort mire
sé me doñé shume,
Me shtrengoñé mé deshire
sa binim nde ghume.

Tashi, ti sé me harrové
é shoh édhé une,
Po, me ghith ce mendjé ndrové
nuk me prishé pune.

Un' é di sé ti faj s' ké
zémren c' é kthévé,
Sé bégatite kur i a pé
me chast é pelcévé!

Ashtu eshte dashuria
kur esht per te shitur;
Per te holla as pléceria
s'esht' é merzitur!

BKSH

I veshtir' eshte durimi

Ah! sa vuañ par ty o vashe
Me mire te mos te ñihña,
Sé u-venita u-tashe
Per ato sychke melliña

As kthéj-u moj sy kaléshé
Mos é ki zemren te gurte,
Sé édhé ashtu t' a késhé
Ghithe do t' ishé m' é urte.

Sa hére udhés ti ce shkon
Édhé tundésh mé madhési
Oh! zemren m' a trét m' a hélmon
Dhé si duroñ as une s' di.

I veshtir' eshte durimi
Dhé sa kéc eshte kur vuan,
Kur shekon sé deshperimi
Flagen é zemres s' t' a shuan.

BASH

Perandaj édhé ñe hére
O mall i zemres te lutém.
A te t' i puth buzet m' i bjére
A ne mos, nde dhét te futém!

BKSH

SE BUKURES

Lésht' é mendafshte prape leshuar
Kur shkon udhes sa te paska hijé,
Edh' ay mézi yt i shtrenguar
Oh! nde semundjé mua ch' me shtié!

O moj chupe vétullat é tua
Zemren m' a docne m' a perveluan,
Ato sychkat mos i hith mi mua
Sé me s' mbahém dot shpirtin m' a shuan.

Buzet é tua nghyre trendafili
Cas-u prane te t' i puth ñe hére,
Édhé gojezen mé ze bilbili
Ném' édh' ate mallin te m' a ndzjére.

Po si manushacéja ne prendvére
Ce chélét é zbukuron fushen,
Dil moj chupeze édhé ñe hére
Te te shoh facén édh' ate gushen!

BKSH

As éja prane thuaj-me te dua
Dhé zghat-m'a ate dore bardhoshé;
Te trétém nuk' te vjén kéc per mua
O moj fiytyreza bukuroshé?!

BKSH

KTHIMÉ

Kur te pashe me s' te lashe
T' u-afruash é s' t' u-ndashe,
Dhé mé ze t' embel te thashe:
„Sa te dua o moj vashe !"
Édhé me ghuñe te rashe
T' u-luta ghér sa u-vrashe.
Po nga zemra pshéretita
U-tréta u-lébétita
Sé as ñe fjale s' te cita,
Ghér sa shprésen far' é ngrita
Sé m' u-merzit sa te prita
Ac sa u-ngrys édhé dita.
Vétem pastaj un' u-zghova
Dhé mendjén t'imé é ndrova
Kur zémren t'a kupetova,
Dhé ika é te harrova
Nga ter' mundimét shpetova
Si édhé shpïrtin é cétova.

BUSH

Pastaj ti mbremanét hére
Me vjén rotull si ñe shcére
Si ñe flytyre nde vére
Dhé me lutésh ace hére;
Po tashi sheko te tjére,
Sé s' te dua moj é mjére!

BKSH

MESHIRE

Hena yjte dridhén
Kur éra siper fryn,
Réhte tutjé mblidhén
Dhé drita kudo hyn.

Véch mua meñtimi
S'me lé t'jém nde gezim,
Sé per 'tê kujtimi
Me shtié nde trishtim.

É di shume mire
Kur me tha : „do te vij".
É mé zemer lire
M'i puthi syt' é mij.

Po me kot s' é prita
Sé ajo s' me harroj,
Sé po sa shkoj dita
Ajo prap' me kujtoj!

BKSH

DJALERIA

Tétembedhjéte vjétsh djale ishté
Dhé burre kur te paren hér' é pâ,
Mendjén nat' é dit' atjé é kishté
É ndjénté sé ñe ghe zémren j' a hâ.
Meñtohéj valle a do t' a doje
Mé acé zjar si ch' é do édh' ay,
Ce tj i thote ñe fjale mé goje
Ñe perkedhélim t' i choje mé sy!

Sa hér' prane déres saj shkonté
Mé mall hithté syte t' a veshtroñe,
Renkimé zemra ghith' i leshonté
Kur meñtohéj sé pa 'te s' munt te roñe.
Ah! thosh me vété, sa é pelcyér,
Ch' trup, ch' fytyre te bukur ce paska
Lésht' é kokes nde ar si te nghyér
Dhé ñe Pérendéshes i u-ncaska!

Ishté ñe nat' é bukur mé hene
Dhé ñe ére é fréske po frynté,
Kur ay nde mendjét é kish vene
Te véje atjé ték zemra é shtynté.
S' meñtohéj faré ne eshte mire
Ne shtepi te huaj te vésh te hysh,
Édhé tjétrit t' i vesh ti brire
Pa me pare te ghykosh si é cysh!

Po zjari i djalerise s' te lé
Te ghitha neper mendjé t' i pershkosh,
É ch' do rézik ce te jéte s' é shéh
Kur ñe deshire do ce te mbarosh.
Esht si bima te dale ce kerkon
Mi facé te dhéut é te shohe
Rézén é djéllit ci per dit' é ngrohn,
Ce te chfréñe dhé jéten t' a ñohe!

Bésonté sé t' vétem do t'a ghénté
T' i thoshté zjarin é zemres c' é djék,
Mé ch' do menyre mendjén t' j'a kthénte
Ci si ñe hijé nat' é dit' é ndjék.
Sa i lumtur ish kur kujtonté
Sé pran' asaj do te flinté mé defrim
Te ghitha bréngat do t' i harrontë
Do te ghénté te te shpirtit cétim!

Ish ñe cétesi édhé ñe pushim
C' as flétet é pémvé s' ushetinin,
Hen' é plotte po ndritté m'é embelsim
Édhé zoghte nde foléte flinin!
Kur ay ce te hyj' u-afrua
Dhé pran' asaj ce dô, te gezohét;
Ñe kertsellim s' di si u-deghua
Dhé burr' i saj nga ghumi zghohét

Mé vrap ñe arme sulét te mare;
Bésonté sé ñéres te lic ishin:
Me mire ay te beñe me pare
Ate ce nder ment ata kishin.
Dhé ñe krisme me hop u-deghua:
Djali râ i vdékur atjé me vent,
Sé s' ghykoj me pare s' u-meñtua
Sé ate ce punon é ben pa ment!

BKSH

TINGELLIM

Per facét é syt' é tû zemra me renkon
Dhé nat' é dit' jam duk' u-meñtuar per 'to,
Mé mall t'i veshtroñ moj chupe udhes kur shkon
Ce kurre nuk me vjén té ndahém nga ato.

Perandaj une ghéndém nde ac' mundimé;
Ah! shpirtit s' munt t'i gheñ as faré cétesi,
Zémra, kur ty te shoh me behét therimé
Vétén é ndjéñ te dobet pa noñe fuci!

Ti mé nenecéshién t'endé embelso-me
Shpirtit t'em jepi ñe fryme te chélét
Édhé nga plagat ce po vuañ shero-me.

Sé véch nga ghiri yt dashuria vjélét;
Pra, édhé mua atjé te vjél lesho-me
Sé mé ate shpirt é zémer me perkedhélét!

NE DESHERIM

Yj te zjarte ciéjsh pikonin
É ndritnin nde éresire,
Ghyrme linin kur po shkonin
Mé madheshti nd' hapesire.

Édhé névé te shtrenguar
Per mézi, ce te dy rinim,
I keyronim pa pushuar
Nga syte faré s' i linim.

Sa meñtohéshim ahéré
Dhé sa mendjé s' na pershkonin,
Kur nde ate nate véré
Ato zémrat na pushtonin.

Oh! te kishim édhé né fuci
Boten ce t'a kapetonim,
Por si yjte, mé lumtesi
Perpjéte te flytyronim.

BKSH

Neper ré ghithe te shetitnim
Dhé détét t'i kaperdzénim,
Malét é lartra t'i nghitnim
Shpirt é zemer te defrénim.

Ne parrais te cendronim;
Dhé mé zemrat te bashkuar
Te lumtur bashke te ronim
Nde dashuri te pa mbaruar!

BKSH

MOS KERKO!

Kur foshña ishim
Dashuri kishim
Si motr' é vella
te dy.

Ti sa me doñé
Kur me veshtroñé
Mé puthñé pa prâ
ne sy.

Céshnim é lonim
Dhé bashke shkonim,
Benim sa é sa
mé ty.

Po, si u-madhové
Me thé : u-ndrové
Mos kerko, ghe s' ka
per ty !

BKSH

BKSH

SATIRIKÉ

BKSH

BKSH

„Shpirti“ i Dhéspotit

Deghomeni Shcipetare
T'u deftéñ ñe ghe te ralle,
Nde Shciperi ce ka nghare
É ka mbétur si peralle.
Mos thoni sé flas fjale te kotta;
Sé ch' do ghe a pune c'eshte bere
Dél shéshit; sé ashtu eshte bota
Ch' deghon édhé shéh, e ndzjér te tere.
Pra, édhé kjo c' u-thém une
Eshte faré é vertéte,
Sé é pane édh' é zune
É me s' eshte pun' é mfshéhte.

Ish nde ñe cytét te Shciperise
Ñe dhéspot mé mesimé te mbedha,
Ci kish ardhur ng' anet é Grécise
Ce te na prédikoje féja ch' ka.
Nde kishe kurdohére ce vinté
Mbanté fjale, dhé keshilla jipté,

Kurre 'noñe hére me vent s'rinté
Po ghith keshtu bésniket i kripté :
O vellézer deghoni,
U-thosh, mé embelsire,
Bésen mos é mohoni
Sé si kejo s' ka m' é mire !
Kjo na meson nde jéte
Te rojme te ndéruar,
Dhé pastaj Zoti véte
Na ka per te békuar.
Ghen' é tjétrit kurre mos lakmoni
As syte te mos i shtini mi 'té,
Po ate ce kini te shekoni
Sé pastaj kjo ne mekaté u-ve.
Keto keshtu ay duk' u-thene
Vét-vétehén nuk' é numuronté
Po me ñ'ane ng'ata é kish vene ;
Sé as ñéri t'a pyése s' kudzonté !
Pa pyésni tashi uraten,
Ay ce keshillon te tjéret,
Valle ch' ben diten édhé naten
Kur nuk' é shohin, si nde t'érret ?
Kete pune as ñe s' é dinté
Pervéch fatit c'ashtu é solli,
Sé mé mikén ay kur rinté
Askujt mendja nuk' j'a polli.
Ay ce boten é mesonté
Si te sillét é si te mbahét,
Vét' ay keto i punonté ;
Si ñe ujk délés ce s'i ndahét.

Ashtu pra ñe dite kur po hanté
Bashke mé ñe miké bukuroshé,

Mézin é saj mé duar j'a mbanté
Édh' i shtrengonté duart bardhoshé.
Oh! ti jé shpirti im! sa te dua
Si ty me s' ka tjater as ghekundi
Ti o shpirt, o pellumb me dô mua?
Dhé si é puth, mjékren é shkundi!
Po ate chast per fat te kéc
Ñe djalosh ci jashte ishté,
Nde ñe vere syrin é ndréc
É, pâ uraten kur é chvishté!
Haj o shpirt te rime ketu
Te lozim te dy te céshim
I-thosh urata, ja keshtu
Edhé vallés t' i a nghéshim!
. . . . . .
. . . . . .
. . . . . .
Ish é Djéle. Shkolla kish provimé
Dhé paresia cé mblédhur atjé,
Mesoñesi i pristé mé ndérimé
Ghithevé sa vinin brenda vent u-lé.
Ja dhé Dhéspoti vjén duké céshur
Dhé mi ñe fron te larter ze vent,
Paresin' é mér si mé te percéshur
Sé ishin te pa ditur munt é pa ment.
Nisén provimét, djémt' i pyésin
Per ch' do pune ce ka dituria,
Per ñérine a kafshet ce vdésin
Ch' behét shpirti c'u dha Pérendia.
Me kot djémte po perpicén
Ce te perghighén si ch' duhét,
É nga robat ghith po hicén.
Kur, ñe, nd' hunde kruhét:

Ch' ké ti or djalosh i thote
Mesoñesi mé ñe chudi,
Psé kthéhésh ashtu si rote
Po s' thua ghekafshe ne di?
Pra, thuaj, ne di pa frike
Si eshte shpirti ce kémi?
Éja me prane ñe chike
Ce te dime sé ku jémi.
„Une di, thote djali, m' émer te Zotit
„Sé shpirti eshte ñe grua é chvéshur,
„Sé é pashe mi ghuñet te Dhéspotit
„Kur ay i thoshte: *o shpirt!* duké céshur!!"

BKSH

LOP' É FSHATARAKUT

Nie fshatarak po canté i ghori
Sé é shocja ahér' i kish vdékur!
Po pas tsa dit' ay zin' é ndzori
Si kur kush-é-di sé kush é kish ndjékur!
Pas tsa kohe prap' zu é po canté
Ch' ké mor? é pyét prifti i fshatit.
Por ay syt se cari me s' i mbanté
Édhé mallkonté oren é fatit.
Nuk' di, tha, me ngordhi ñe lope c' kisha
Ce me ushcénté tere shtepine,
Ish é majm' édh' é bukur si bisha
Édh' é doña ac' sa Pérendine!
Chudi, i thote prifti, nuk' me thua
Psé per t' et shocé sa kac pushové
É per ñe lope ce s' eshte grua
Ac' jave se cari u-terbové?
Me ndjé, urate, grâ ghéñ sa te dua
Po lope ku te ghéñ? nuk' me thua?!

GEÑÉSHTR' É NASTRADINIT

Ch' ben Nastradin ? é pyésin
Micte udhes kur é pjékin,
Dhé sikur duan t' a shésin
Ashtu mé fjale é ndjékin.
Ch' kini mé mua, u-thote
É s' me lini nde cétesi,
Po m' u-mblothté rréth si rote
Sikur shekoni ndoñ' ari ?
Te dime se jé ñe ñéri
Ce di shum' ata i thone,
Dhé ti tashi sikur s' é di
Si é kémi né zakone ?
Thuaj-na pa u-meñtuar
Ñe geñéshtre te pelcyér,
Mé ghithe ce pake je ndruar
É nde facé si kembyér !
Jû, or mic, céshni mé mua
Sé nuk' dini ch' me ka nghare,
Dhé jam mvérdhur si limua
Sé nuk' di ch' te beñ me pare.

PUSH

S' dini sé me vdic im ate
Édhé s' kam mé sé t' a mbuloñ,
Ghumi s' me zu kete nate
Si te beñ é si te shkrétoñ!
Kete nuke me mesoni
Si é cysh esht per te bere,
Po jû ghithe me trazoni
Si te chmendur ce te tere!
Ch' thua mor? Ty t'u-nghatt' jéta
Ay tashi shkoj é vaté;
Edhé zu mé te vertéta
Te cañe! Por ata, ch' paté?
Pushô, mjaft, sé te ndihim né
Te mbulosh t' et ate mé ndér,
Per kete ti kujdés me s' ké
Sé s' te léme te jésh nde vrér.
É te ghith' duart i futne
Nde taske mé vrap mé ndzitim,
Ghér sa hélmimin j' a zbutne
Kush shume kush pak pa zemrim.
Nastradini si pa keshtu
I kenacur u lé shendét:
„T' a thyéñ cafen ce ketu
Sé pastaj kushédi ch' me nghét."
Édhé po sa kaperdzéu
Udhen, iku é me s' u pa,
Ata mire si i geñéu
Édhé ghith atjé si i la.
Po shume kohe nuk' vonoj
Ata nga ay c' u-ndane,
É per pak ay ce kur shkoj;
Dich shekojne per matane!
Cé i âti! ce po vinté
Dhé mé ata u-bashkua,

É sitsili syt' i shtinté
Kur prane tyré u-shtrua.
Ata tashi kupetuan
Sé Nastradini i geñéu,
Dhé geñéshtren j' a paguan
Sa as atij mendja s' j'a préu!
Nastradini prape kur vjén
I ghén si te zemeruar;
Po s' prish ghe kur vétén é ndjén
Te ngrohet' é te gezuar!
— Psé na thé sé vdic yt ate
Kur ay tashi ketu cé,
Po na geñévé ce mé nate
Sikur ment, i thone, nuk' ké?
— Psé me kot jû zemerohi,
U-perghighét mé embelsi,
Dhé faré nuk' meñtohi
Po ghithe flisni mé meri?
Nuk' me kerkuat ce t' u thém
Ñe geñéshtre pa meñtuar,
Tjater mé juvé ch' do te kém
Ce me rini zemeruar?
Pa ne mos é kupetuat
Geñéshtren ce un' u-thashe,
Juvé ghithe m'a paguat:
Mé ñe page pak te trashe!!

KRISHTI GRÉK

Pyésin ñe Grék mé ment ñe hére:
— Aléksandri i Math ku kish lére?
— Ne Macédhoni, perghighét ay,
Édh' ish Grék; sé ñihéj ne ball' é sy!
Po Burrin ch' é béson ti sé ish?
Sé ay as tsope mish Gréku s' kish!
— O, jé nde gabim, thot', or Zoteni
Po Épiri valle s' eshte Gréci?
— Chudi! Ahéré thuaj ch' cé Krishti
Sé me dukét ghithe do te dish ti,
Dhé si ch' shoh jû te ghitha i dini
Kur tere boten nde dor' é shtini!
— Ketu véch ne mos ishté noñe shték...
Bésoñ sé dhé Krishti cé ghithe Grék!
— Mire! Po gomari ch' munt te jéte
Sé nde Gréci nga keta mûnt t' kéte...
— Kete or vella, s' munt t' a di
Sé ghér sot s' m' a ka thene as ñéri.
— Po at' héré ti cenké geñéshtar
Kur thua sé di, é levdohésh si gomar!!

BUSHT

Rréth mesalles

blidhuni o shoke
Ketu rréth mesalles,
Véren mé oke
Me vent te dhalles,
T' a hédhim t' a pime
Kupat t' i chkullojme
Pastaj te rime
Dhé te kendojme.

Ch' na duhét dituri
Dhé mesimé te mbedha,
Kur per ch' do ñéri
Ghe m' é mire s' ka;
Si véra ce na fton
Jéten t' a gezojme
Sé koha po shkon
Dhé shume s' rojme.

Éjani pra ketu
Faré mos vononi,
Ne kini pak tru
Dhé doni t' roni.

BISH

Véra é rakija
Kejo eshte jéta,
Mésimi, dija
Jane te méta!

Rréth mesalles rini
Édhé mé kupat plot,
Vallés u-zini
Dhé véres me not.
Te pini pa fjale
Sa te mundni o shoke
Zemrimi t' u-dale:
Te behi troke!

BKSH

Trimeria é Shcahut

Sulltani i Turcise déshté te provonté
Trimerin' é kombevét c' ay urdherontë,
Te shohe tsili eshte me trim édh' i chcuar
Ce t'a kéte nde ch' do lufte per te derguar.
Te jét' i math édhé balla é ushterise
Édhé kryé é kombevét te mbréterise.
Pra per kete pune ñe dite u-meñtua
Ghér sa ñe mendim i bukur i u-kujtua.
Te therrése nde pellas vétem ñ'a tré véta
T'i provoje ce te shohe ku 'sht' é vertéta.
Édhé mé ndzit sherbetorevét u-urdheron
Ce t'i sjéllin nga vendi c' ay mbréteron
Tré ñéres ; ñe Shcah, ñe Turk, édhé ñe Grék bésnik
Sé vétem keta hidhén nde zjar per ch' do rézik.
Si vijne keta prane, Mbréti mé deshire
U-thote sé si juvé, as kam me te mire.
Perandaj u-thirra t'u thém ñ'a dy tri fjale
Sé di ce jini trima é burra pa pale
Po me pare dua t' u-shekoñ trimerine
Ce te di kujt t'i jap ne dore ushterine.

Édhé t'a ndéroñ mé shenimé te mbedha
Ce ndoñe tjater nde Mbréterit t' imé s' ka.
Pra rini pake ketu, prape ghér sa te vij
Sé kam tsa pune mé keshilloñesit é mij.

Mbréti si dolli jashte, ñe ushtetar therét
Édh' i tha te ngarkoje ñe top si beri vjét.
T'a mbushñe mire mé barut ce te kertsase
Dhé kur ay t' i urdheroñe, zjar te kllase.
Pastaj kthéhét prape édh' i ghén te tré me vent
Flisnin, céshnin, sé mé Mbrétin ishin nde kuvent.
Mbréti si hyn nde ñe dhome, atjé me ñ'ane
Urdheron t' i vene zjar sa mundét me prane.
Kur or' u aferua, dhé topi si krisi
Mbréti nga é céshura robat dich i grisi,
Sé Turku dhé Gréku prape me s' pane
Muar syte, dhé as ata s' dine ku vane.
Vétem Shcahu cé mê trim sé me vent mbéti
Sé Mbréti kur hyri vétem kete é ghéti!
Te lumte, i thote, kurre nuke bésoña
Te jésh ti ace burr' é trim si te kerkoña.
Pra, gezoném sé kam ñéres pa frike si ty
Dhé sa te jésh te vish prane te te kém nene sy.
Tashi ch' do ghe nga mua ti po te kerkosh
Une jam gati te t' jap ; é ce te me bésosh
Ja ku t' ap fjalen t' imé, dhé kurre nuk' é kthéñ
Dhé haj te hame dréke, mos thuash sé te genéñ.
Por Shcahu : Madheni, thote, ghér sa te viñ per dréke
Te lutém thuaj te me sjéllin ñe pale.... bréke!!

Lufta Turko-Gréké

Lufta kur u-fillua
Gréket ghithe bésonin
Sé Turku u-cerua
É me kot po luftonin.
Po kur te trash' é pane
Sé lufta nuk' fitohét
Dhé' nuk' hicét me ñ'ane
Armiku s' frikesohét,
Gréket hyne nde kuvent
Te ghith te keshillohén,
Te beñe punerat mé ment
Pastaj te mos pendohén.
Kur armiku u-hyri
Dhé *kryén* do t' u-kapté,
Ay, sa te mbyllét syri
Luft s' kish mé ke te hapté.
Sé palikaret shkuan
Ñe ore mê perpara,
Turcit kur i rréthuan ;
Ghétne fushat te lara.

BUSH

Gréket punuan mire
Sé ikn' é me s' u-vrane
Si trima te pa vdire
Chkelcyén an' é mb'ane.
Pastaj bota kudzojne
Te thone per ñe hére
Sé Gréket kur luftojne
Mundén si pak te tjére.

. . . . . .

Chudi ! si ashtu mundén
Kur Turcit nuk' i zune :
Sé dhé sot ghith po tundén
Sé ata posht' i vune ! !

BKSH

ÑE KESHILLE

Zotit....

Kujt vétja é tij i pelcén
É thote sẽ ch' do ghe é di,
Mé kete ay nuk' deftén
Pervéch sé esht nde maresi.

Ne i k'enda t' a levdoñe
Si ch' perpicét te reféhét;
Duhét mire te veshtroñe
Nde balte mos rekelléhét.

Dhé ce te dije mê mire
Ne ka t' atille fytyre,
Si ch' deftéhét mé pahire:
Lé te shihét nde pascyre!

BKSH

Jéta é mire!!

Hani é pini sa mê shume
Dhé mendjén faré mos é vrisni,
Véra lé te dérdhét si lume
Sé si néser ghith do te vdisni.

Sa ñéres t' mentshem kane cene
Boten ce é kane trazuar,
Ghithe si né é patne thene
Te vdésin ghe pa trasheguar.

Lart kupat! jéten t' a gezojme
Dhé mé zémren keshtu nde defrim,
Diten édhé naten t' a shkojme
Duké larguar nésh ch' do trishtim!

Ch' bésoni sé do te fitoni
Ashtu ghithe duké punuar,
Édhé tasken ju é shtrengoni:
Te tjére per t' i gezuar?!

BIBLIOTEKA

Dumbovitsa*)

Dumbovitse uje mjalte
Zoti jéte mos te falte,
Sé ujen t' endé kush é pi
Me s' shéh as femij' as shtepi!

Dumbovitse uje ari
Ce me s' ngopét nga se pari,
Ch' do ñéri ci prane ty shkon
Kur mé mall ri dhé te veshtron!

Dumbovitse lum' i ghate
S' di psé zémra m' esht é thate,
Sé sa hére ty te kujtoñ
S' munt te ikiñ; é te mallkoñ!

*) Lum' i Bukuréshtit.

BKSH

Mesalla é vjérshavét

Parethenié . . . . . *facé* 6

Vjérsha atdhésié

Kenge lirié . . . . . *facé* 13
Flamuri kombetar . . . . . „ 17
Ardhi dita . . . . . „ 19
Bota . . . . . „ 21
Keshille . . . . . „ 22
Palla é Skendérbéut . . . . . „ 24
Bése dhé Shprése . . . . . „ 26
Dyshim . . . . . „ 29
Dua . . . . . „ 32
Poshte éresira . . . . . „ 34
Deshire . . . . . „ 37
Zeri i flamurit. . . . . . „ 39
Tingellim. . . . . . „ 41
Malli i atdhéut . . . . . „ 42
Miaft . . . . . „ 44
Atjé . . . . . „ 47
Shcipetar i vertéte. . . . . . „ 49

BKSH

Grékomonet . . . . . *facé* 52
Girolamo de Rades . . . . . „ 55
Détetar . . . . . „ 56
Nata é mram 'é Skanderbégut. . . . . . „ 58
Mallekim . . . . . „ 63
'Le fala . . . . . „ 64
Lark vatres. . . . . . „ 66
Thirié zghimi . . . . . „ 69
Pyétjé dhé perghighié . . . . . „ 72
Detyre kini . . . . . „ 73
Ali pashe i Tépélénit . . . . . „ 75
Lutié dhé Mallekim . . . . . „ 78
Dhémbke. . . . . . „ 83
Punoni pa-prére . . . . . „ 85
Vajtim . . . . . „ 87
Per Shcypniin . . . . . „ 89
Shcipetarevét . . . . . „ 91
Naim béj Frasheri . . . . . „ 94
Kesollés . . . . . „ 96
Per atdhéén. . . . . . „ 99

Vjérsha fushoré

Frori . . . . . *facé* 105
Punetori i mire . . . . . „ 108
Ardhj' é prendvéres . . . . . „ 110
Natyra . . . . . „ 112
Prendvéra . . . . . „ 114
Shiu . . . . . „ 116
Mbremanét nde fshat. . . . . . „ 118
Flytyra . . . . . „ 120
Shélghét . . . . . „ 122
Bariu . . . . . „ 124
Dimeri . . . . . „ 126

BKSH

Mendimetaré

Ñe ender . . . . . *facé* 131
Mentimé . . . . . „ 137
Pérendia . . . . . „ 139
Puna . . . . . „ 141
Cétesia é zémres . . . . . „ 143
I burgosuri . . . . . „ 145
Dhéu i huaj . . . . . „ 147
Lumtesia . . . . . „ 150
Perfytyrimé . . . . . „ 151
Vertítesia é gherravét . . . . . „ 153
Féja é vertéte . . . . . „ 155

Dashurié

Dashuria . . . . . *facé* 167
Ñe ore lumtesiê . . . . . „ 169
Malli i Lénkes . . . . . „ 171
Dinakeri . . . . . „ 173
Malli i péshketarés . . . . . „ 174
Prane téjé . . . . . „ 175
Fucia é dashurise . . . . . „ 176
Bej ñe te mire . . . . . „ 178
Ñe zakon . . . . . „ 180
Harrimi . . . . . „ 183
S' ké ti faj . . . . . „ 185
I veshtir' eshte durimi . . . . . „ 186
Se bukures . . . . . „ 188
Kthimé . . . . . „ 190
Meshire . . . . . „ 192
Djaleria . . . . . „ 193
Tingellim . . . . . „ 196
Ñe desherim . . . . . „ 197
Mos kerko! . . . . . „ 199

BIBLIOTEKA

Satiriké

Spirti i Dhéspotit. . . . . *facé* 203
Lop' é fshatarakut . . . . . „ 207
Geñésthtr' é Nastradinit. . . . . „ 208
Krishti Grék . . . . . „ 211
Rréth mesalles . . . . . „ 212
Trimeria é Shcahut . . . . . „ 214
Lufta Turko-Gréké . . . . . „ 216
Ñe keshille . . . . . „ 218
Jéta é mire. . . . . „ 219
Dumbovitsa. . . . . „ 220

BKSH

BKSH

BASH

ÉTABLISSEMENTS ❊ ❊ ❊ ❊
❊ ❊ ❊ DES ARTS GRAPHIQUES
„UNIVERSALA“
BUCAREST, COVACI, 14.

BKSH

BKSH

BKSH


BKSH